

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5570  
E premte, 7 shtator 2018  
çmimi 0.40 €

## Nuk arrihet unitet për dialogun



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE" DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË KOSOVËS, RASHIT QALAJ

## Do ta rris transparencën dhe integritetin në polici

Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, në një intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ka treguar për objektivat e mandatit të tij në krye të këtij institucioni. Ai ka thënë se një nga objektivat kryesore do të jetë rritja e transparencës në polici në të gjitha fushat. Qalaj është zotuar se do të punojë edhe për rritjen e integritetit të policisë. Sipas tij, ky institucion ka nevojë për reformë të strukturës organizative, reformim të administratës dhe decentralizim të personelit. Qalaj ka

bërë me dije se sfida mbeten sigurimi shëndetësor për zyrtarët policorë dhe mosha mjaft e vjetër e policëve. Për të dyja këto sfida ai pret ndihmën e Qeverisë. Duke folur për anëtarësimin në Interpol, ai ka thënë se gjasat janë të mëdha që të bëhen pjesë e këtij institucioni. Qalaj në këtë intervistë ka folur edhe për akuzat që janë bërë nga opozita për emërimin e tij në këtë pozitë



### AKTUALE

#### SISTEMI ARSIMOR DHE LËNDËT SHOQËRORE

Muhamet KRASNIQI



#### STABILIZOHET FURNIZIMI ME BARNA NË QKUK

#### KOSOVA E GATSHME TË MARRË PJESE NË MISIONE PAQERUAJTËSE

### EKONOMI

#### MEHMETI: BQK-ja PO PËRMBUSH STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RREGULLATIVËS FINANCIARE

KA FILLUAR PUNIMET KONFERENCA E PESTË E AMBASADORËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

## Diplomacia merr vlerësime pozitive nga liderët shtetërorë



Drejtesit e institucioneve shtetërore, presidenti Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri Veseli, kryeministri Ramush Haradinaj dhe zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli, kanë shpalosur orientimet mbi politikën e jashtme në konferencën e pestë të ambasadorëve, duke vlerësuar lart rolin e diplomacisë së Kosovës. Ata kanë bërë me dije se në koordinim me sponsorët e pavarësisë po punohet për anëtarësimin e Kosovës në BE, OKB, Interpol, UNESCO dhe në organizata të tjera ndërkombëtare



## Haradinaj i kënaqur me dinamikën e punës në autostradën 'Arbën Xhaferi'

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

### SPORT



#### KOSOVA DHE SHQIPËRIA SONTE DEBUTOJNË NË LIGËN E KOMBEVE

#### 'ARUSHA' PENSIONOHET NGA FUTBOLLI

## Vuçiqi anulon vizitën në Kosovë?

**PRISHINË, 6 SHTATOR** - Vizita e presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka gjasa që do të anulohet. Vuçiqi është afër vendimit që ta anulojë vizitën në Kosovë dhe ka urdhëruar që të ndërpriten të gjitha kontaktet me Prishtinën, kurse vazhdimi i bisedimeve në Bruksel

që është caktuar për të premten, me gjasë do të anulohet, ka njoftuar gazeta serbe "Večernje Novosti", transmeton "Epoka e re". Kjo gazetë shkruan se institucionet e Kosovës e kanë njoftuar Beogradin që presidentit të Serbisë do t'i ndalohet që ta vizitojë liqenin

e Ujmanit e që, sipas gazetës, ky është një provokim të cilin Vuçiqi nuk dëshiron dhe nuk mund ta durojë. Sipas "Večernje Novosti", mund të ndodhë që presidenti serb, Vuçiq, sot (e premte) do t'i drejtohet popullit. Presidenti i Kosovës, Hashim

Thaçi, dhe ai i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, është paralajmëruar se do të takohen sot (e premte) në Bruksel për vazhdimin e dialogut Prishtinë - Beograd. Për takimin ndërmjet presidentëve këto ditë ka njoftuar Përfaqësuesja e Lartë e BE-së, Federica Mogherini.



# Stoltenbergu: S'ka anëtarësim në NATO pa kaluar referendumi për emrin

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s ka thënë se Maqedonia do të bëhet anëtare e NATO-s nëse e zbaton marrëveshjen për emrin. "Shpresoj se herën tjetër kur do të jem këtu, do të vij në një vend anëtar të aleancës", ka deklaruar Stoltenbergu

**SHKUP, 6 SHTATOR** - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka deklaruar të enjten në Shkup, se Maqedonia mund të bëhet anëtare e aleancës veriatlantike nëse e zbaton marrëveshjen për emrin me Greqinë. "Nëse e implementoni marrëveshjen për emrin, ju do të bëheni shtet anëtar i NATO-s. Shpresoj se herën tjetër kur do të jem këtu, do të vij në një vend anëtar të aleancës", ka deklaruar Stoltenbergu.

Zyrtari i lartë i NATO-s ka nënvizuar se e ardhmja e Maqedonisë është në duart e qytetarëve të saj. "Për disa javë do të keni referendum, ku duhet të vendosni për ardhmërinë, për anëtarësim në NATO dhe në Bashkim Evropian. Ju duhet të vendosni si do të votoni në atë referendum. NATO-ja është e gatshme t'ju pranojë si anëtarin e 30", ka theksuar ai.

Por, nga kabineti i presidentit të Maqedonisë njoftojnë se gjatë takimit që ka pasur sekretari i përgjithshëm i NATO-s me presidentin e shtetit, Gjorgje Ivanov, ky i fundit i ka thënë zyrtarit të lartë të NATO-s se Maqedonia mbetet e përkushtuar për t'u integruar në NATO

dhe BE, por kjo nuk duhet të merret si alibi për një marrëveshje të keqe duke e cilësuar kështu marrëveshjen në mes të Maqedonisë dhe Greqisë për çështjen e emrit. "Besoj se vendi i vërtetë i Maqedonisë është në Bashkimin Evropian dhe NATO. Por, BE-ja dhe NATO në asnjë rast nuk guxojnë të jenë alibi për marrëveshje të keqe", theksohet në njoftimin nga kabineti i presidentit Ivanov. Në pyetjen e gazetarëve për këtë çështje, zyrtari i lartë i NATO-s tha se gjatë takimit që ka pasur me liderin e opozitës maqedonase, Hristian Mickoski, dhe presidentin e Maqedonisë, Gjorgje Ivanov, të cilët janë kundër marrëveshjes Maqedoni - Greqi për çështjen e emrit, u ka dhënë një porosi të qartë se "Maqedonia nuk mund të bëhet pjesë e Aleancës Veriatlantike nëse nuk e zbaton marrëveshjen për emrin". "Mesazhi im në këto takime ishte se kjo është një mundësi historike për këtë shtet. Është mundësi e shansit jetësor, mundësi që vjen një herë në jetë për t'u bërë pjesë e komunitetit ndërkombëtar, për t'u bërë anëtare e NATO-s, për t'u bërë anëtare e Bashkimit Evropian. Por, për të arritur



këtu, ju duhet ta përmbushni marrëveshjen e emrit. Nuk ka rrugë tjetër, nuk ka rrugë alternative për në NATO. "Nuk ka asnjë mundësi që të anëtarësoheni në NATO pa marrëveshjen e emrit. Pra, ju ose mund t'i thoni po marrëveshjes dhe po NATO-s, ose jo marrëveshjes, por ashtu i thoni jo edhe anëtarësimin", ka sqaruar Stoltenbergu. Ai ka shtuar se është iluzion të shpresohet në integrimet euroatlantike duke e refuzuar marrëveshjen në fjalë. Ndërkaq kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, ka theksuar se pret që edhe opozita të bëhet pjesë e këtij procesi shumë të rëndësishëm, duke marrë pjesë në referendum. Zaevi është shprehur i bindur se referendumi do të jetë i suk-

sesshëm pas të cilit do të pasojnë edhe ndryshimet kushtetuese si pjesë e marrëveshjes Maqedoni - Greqi. "Pres që partitë politike relevante, veçanërisht opozita, do të jetë e bashkuar dhe do të bëhet pjesë e procesit", ka thënë Zaevi. Edhe ministrja e Mbrojtjes e Maqedonisë, Radmilla Shekerinska, është shprehur e bindur se më 30 shtator qytetarët e Maqedonisë do të votojnë në referendum pro marrëveshjes Maqedoni - Greqi. "Më 30 shtator jam e bindur se qytetarët e Maqedonisë do të na mbështesin që Maqedonia të bëhet anëtarja e 30 e Aleancës", ka theksuar ajo. Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, i cili në Shkup vjen për

herë të dytë gjatë këtij viti, është takuar edhe me kryetarin e Parlamentit, Talat Xhaferi. Gjatë ditës Stoltenbergu e ka vizituar edhe kazermën Ilinden, me ç'rast ka marrë pjesë në ushtrimin demonstrues të pjesëtarëve të Forcave Speciale. Po ashtu, Stoltenbergu ka vizituar dhe rajonin e Stajkovcit, i cili ishte goditur nga përmbytjet më 2016, kur ushtarë të NATO-s ishin angazhuar për tejkalimin e pasojave. Pas vizitës së kreut të NATO-s, sot (e premte) në Maqedoni do të arrijë për vizitë edhe kancelari austriak Sebastian Kurz, ndërsa nesër (e shtunë) kancelarja gjermane Angela Merkel, vizita e së cilës konsiderohet historike.

## Opozita përplasjet me policinë në Elbasan

**TIJANË, 6 SHKURT** - Kryeministri Edi Rama është pritur me protestë në Elbasan, ku kishte programuar një takim me mësuesit. Përpara nisjes së takimit të kreut të ekzekutivit në Gjimnazin "Dhaskal Todri", mbështetës të opozitës, qytetarë

dhe deputetët e saj ishin grumbulluar në trotuarin përgjatë bulevardit "Aqif Pasha" pas "Kryqëzimit të 1 Majit", përballë shkollës. Grumbullimi i qytetarëve po monitorohej nga dhjetëra forca policie, që kishin krijuar një

gardh përgjatë bulevardit. Menjëherë pas mbërritjes së kryeministrit, protesta opozitare është acaruar dhe ka pasur përplasje mes qytetarëve dhe efektivëve të policisë. Protestuesit mbanin në duar pankarta të tilla si "Qeveri narko-

trafikantësh, largohuni", "Qeveri hajdute", "Elbasani i qytetarëve" etj. Ndërkohë tubimi i tyre vjen pak orë pasi fronti opozitar në Elbasan zhvilloi takim në Hotel Turizmin "Scampa", duke vendosur hapat që do të ndërmarrin për aksionin e tyre politik.



Ka filluar punimet konferenca e pestë e ambasadorëve të Republikës së Kosovës

# Diplomacia merr vlerësime pozitive nga liderët shtetërorë

**EPOKA  
ERE**

Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 6 SHTATOR** - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, të enjten ka thënë se Kosova ka një trupë diplomatike me të cilën duhet të krenohet. Ai ka bërë me dije se në koordinim me miqtë dhe sponsorët e pavarësisë së Kosovës po punohet për anëtarësimin në BE, në OKB, në Interpol, në UNESCO dhe në organizata të tjera ndërkombëtare. "Ne po i kundërvihemi në çdo cep të botës, një veprimtarie destruktive të shtetit fqinj, i cili nuk do ta pranojë se historia nuk kthehet pas, ndaj po stimulon kinse revokim të vullnetit të shteteve që na kanë njohur", ka deklaruar Pacolli në konferencën e pestë të ambasadorëve të Republikës së Kosovës që po mbahet në Prishtinë nën përkuajtjen e Ministrisë Punëve të Jashtme. Ai ka bërë thirrje të punohet edhe më shumë për imazhin ndërkombëtar të Kosovës në mënyrë që vendi ynë të shndërrohet në histori suksesi. Pacolli ka paraqitur prioritetet e MPJ-së dhe angazhimet për ndërtimin e një shërbimi diplomatik efikas, profesional dhe dinjitoz. Ai ka folur edhe për zhvillimin ekonomik dhe procesin e dialogut me Serbinë. "Në vend të ndarjes apo shkëmbimeve territoriale, ne duhet të propozojmë zona të lira ekonomike ndërkufitare. Shkëmbimet territoriale kanë pak gjasa për sukses në kushtet e pabarazisë midis palëve negociatore dhe kanë rrezikun të shndërrohen në precedent negativë në rajon apo dhe më gjërë", ka theksuar Pacolli. Ndërsa presidenti Hashim Thaçi



Drejtnesit e institucioneve shtetërore, presidenti Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri Veseli, kryeministri Ramush Haradinaj dhe zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli kanë shpalosur orientimet mbi politikën e jashtme në Konferencën e Pestë të Ambasadorëve, duke vlerësuar lart rolin e diplomacisë së Kosovës. Ata kanë bërë me dije se në koordinim me sponsorët e pavarësisë po punohet për anëtarësimin e Kosovës në BE, OKB, Interpol, UNESCO dhe në organizata të tjera ndërkombëtare

gjatë adresimit të tij ka vlerësuar se ambasadorët e Kosovës janë hallka më e rëndësishme e shtetit dhe shoqërisë. Ai ka theksuar se kjo dekadë ka qenë e sfidave dhe arritjeve të mëdha. Sipas Thaçit, institucionet e vendit e vlerësojnë lart punën, angazhimin dhe sakrificën e ambasadorëve të Kosovës. "Sot jemi të pranishëm në të gjitha kontinentet, në të gjitha anët e globit dhe zëri ynë dëgjohej në tërë botën. Kjo është meritë e punës dhe e përkushtimit tuaj", ka thënë Thaçi, duke shtuar se Kosova ka bërë hapa të mëdhenj në konsolidimin e shtetësisë. Ai ka deklaruar se është krijuar një momentum i ri ndërkombëtar në favor të marrëveshjes përfundimtare për normalizim të marrëdhënieve në

mes të Kosovës dhe Serbisë. Sipas Thaçit, mbyllja e procesit të dialogut me Serbinë do t'i hapë rrugë një faze të re të diplomacisë së Kosovës. Kurse kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka thënë se nuk ka forcë që mund ta ndalë të ardhmen e shtetit të Kosovës në zhvillim dhe integrim të plotë në OKB, BE dhe në organizata të tjera. Ai ka theksuar se përmbyllja e dialogu me Serbinë duhet të bëhet në funksion të vazhimit të agjendës evropiane dhe përmbylljes së subjektivitetit ndërkombëtar, si shtet i pavarur dhe sovran. "Sovraniteti dhe integriteti territorial i vendit tonë janë parime të panegociueshme. Njohja reciproke në mes të Kosovës dhe Serbisë është e vetmja alternativë e

mundshme për të ardhmen. Dhe bashkë me këtë edhe anëtarësimi i Kosovës me të drejta të plota në OKB, për të vazhduar me anëtarësimin në NATO dhe në BE. Nuk ka forcë që mund ta kthejë pas realitetin e ri të Kosovës", ka deklaruar Veseli. Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se Kosova është e vendosur për t'i takuar botës euroatlantike dhe koalicionit kundër luftës së terrorizmit. "Ambasadorët kanë mjaft tema dhe procese me të cilat ata mund ta prezantojnë Kosovën në vendet ku shërbejnë dhe duhet të punojnë në këtë drejtim. Është i pazoti ai ambasador i cili thotë se Prishtina nuk u dërgon instruksione. Nuk keni të drejtë", ka theksuar ai.

Haradinaj ka folur për konsolidimin e brendshëm të Kosovës, për të cilin ka thënë se është proces jo i lehtë. "Do të gjenden mënyra që Kosova të mos mbetet vetëm absorbuese e ndihmës së aleatëve tanë, por duke qenë edhe partner i tyre. Vlerë e re është edhe kontributi i Kosovës në luftën kundër kimit transnacional. Është logjikë e gabuar e Serbisë që ta pengojë anëtarësimin e Kosovës në Interpol", është shprehur ai, duke shtuar se tashmë janë kryer të gjitha proceset paraprake të rëndësishme për tranzicionin e FSK-së në ushtri. Haradinaj ka folur edhe për procesin e dialogut me Serbinë, duke thënë se duhet të arrihet një marrëveshje ligjrisht e obligueshme me shtetin fqinj.

## Policia shënon 19-vjetorin e themelimit



**PRISHTINË, 6 SHTATOR (ER)** - Policia e Kosovës ka shënuar të enjten 19-vjetorin e themelimit. Në këtë përvjetor kanë marrë pjesë krerët e shtetit dhe përfaqësues ndërkombëtarë. Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka thënë se Policia e Kosovës që nga ditët e para, e posaçërisht pas pavarësisë së Kosovës, u bë shtylla jonë më e fortë e shtetndërtimit. "Me krenari e them gjithmonë, se raportet e shumta ndërkombëtare e vendosin Policinë e Kosovës lart mbi policitë e vendeve të rajonit. Ky institucion i ka dhënë Kosovës shumë. I ka dhënë arsye për të qenë krenar. I ka dhënë kuadro që kanë udhëhequr e po udhëheqin insti-

tucionet më të rëndësishme të vendit. Ju i keni dhënë Kosovës edhe heronj si Enver Zymberi dhe shumë të tjerë. Sot e mot përulemi para jetës dhe veprës së tyre", u shpreh presidenti Thaçi. Edhe kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka thënë se Policia e Kosovës ka bartur mbi supë barrën e garantimit të sigurisë për të gjithë qytetarët si dhe zbatimin e ligjit, duke u rritur në një shërbim profesional dhe me integritet. "Me ligjin e ri për pagat, Qeveria, duke vlerësuar përkushtimin ndaj detyrës dhe besnikërinë ndaj atdheut, ka siguruar pagë të dinjitetshme për pjesëtarët e policisë", ka thënë Haradinaj.

Flet për "Epokën e re" drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj

# Do ta rris transparencën

Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, në një intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ka treguar për objektivat e mandatit të tij në krye të këtij institucioni. Ai ka thënë se një nga objektivat kryesore do të jetë rritja e transparencës në polici në të gjitha fushat. Qalaj është zotuar se do të punojë edhe për rritjen e integritetit të policisë. Sipas tij, ky institucion ka nevojë për reformë të strukturës organizative, reformim të administratës dhe decentralizim të personelit. Qalaj ka bërë me dije se sfida mbeten sigurimi shëndetësor për zyrtarët policorë dhe moshja mjaft e vjetër e policëve. Për të dyja këto sfida ai pret ndihmën e Qeverisë. Duke folur për anëtarësimin në Interpol, ai ka thënë se gjasat janë të mëdha që të bëhen pjesë e këtij institucioni. Qalaj në këtë intervistë ka folur edhe për akuzat që janë bërë nga opozita për emërimin e tij në këtë pozitë



**EPOKA E RE** **Muhamet KOÇI**

**PRISHTINË, 6 SHTATOR** - Drejtori përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, është zotuar se gjatë mandatit të tij do të ketë për objektiv rritjen e integritetit dhe transparencës në këtë institucion. Ai ka treguar se synon ta reformojë Policinë e Kosovës në disa aspekte dhe ta rrisë cilësinë e shërbimeve për qytetarët. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", në të cilët ka folur për objektivat e tij në krye të policisë, Qalaj ka thënë se ky institucion ka nevojë për reformë të strukturës organizative, reformim të administratës dhe decentralizim të personelit. "Synim tjetër imi është të rritet transparenca në të gjitha fushat, atje ku është e nevojshme. Në plan të parë e kam rritjen e transparencës me organet e rekrutimit, pastaj rritjen e transparencës në promovim, rritjen e transparencës me medie. Synimi im është që zyra ynë për medie të punojë deri në orën 24:00. Në mënyrë që sa herë që kanë nevojë mediet ta kontaktojnë policinë dhe të ketë çdoherë zyrtarë të policisë që janë në detyrë për t'ua ofruar informatat e nevojshme medieve", ka thënë Qalaj.

Ai ka treguar për hapat që do t'i marrë në drejtim të reformimit të këtij institucioni. "Objektiv primar i brendshëm imi është rritja e integritetit të Policisë së Kosovës, ku secili zyrtar policor të jetë me integritet të lartë. Synoj ta bëj një reformë të strukturës organizative, mirëpo kjo kërkon një analizë të detajuar, të nevojave, të zhvillimit të rrethanave. Pastaj synoj reformim të administratës, meqenëse konsideroj se e kemi një administratë mjaft të ngarkuar. Do ta bëj një

decentralizim të personelit, gjithmonë duke konsideruar se në nivelin qendror ka një numër mjaft të madh të personelit, ndërsa konsideroj se personeli më i madh duhet të jetë në stacione policore, atje ku kryhen shërbimet dhe ku është kontakti i parë me qytetarin", është shprehur ai.

Në këtë intervistë Qalaj ka folur edhe për ndihmën që do t'i ofronte policisë anëtarësimi i Kosovës në Interpol. Ai ka shprehur optimizëm se kësaj here Kosova do ta arrijë të bëhet anëtare e kësaj organizate ndërkombëtare. Qalaj nuk ka dashur t'i komentojë kritikën e subjekteve politike drejtuar këtij institucioni. Sipas tij, për këtë institucion më së miri flasin hulumtimet vendore dhe ndërkombëtare, ku Policinë e Kosovës renditet lart mbi policitë e rajonit.

**"Epoka e re":** Z. Qalaj, sapo jeni emëruar drejtor i përgjithshëm i Policisë së Kosovës. Si e gjetet këtë institucion?

**Qalaj:** Që një javë jam emëruar në pozitën e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës. Në pesë vjetët e fundit kam punuar këtu në Shtabin Qendror dhe e njoh mirë gjendjen e këtij institucioni në përgjithësi. Konsideroj se Policia e Kosovës është në gjendje të mirë dhe profesionale. Natyrisht se sikurse çdo drejtor i ri, edhe unë kam synimet dhe objektivat e mia për ta zhvilluar më tej këtë institucion dhe për ta bërë sa më profesional.

**"Epoka e re":** Cilat janë objektivat e juaja që synoni t'i arrini gjatë mandatit tuaj?

**Qalaj:** Objektiv primar i brendshëm imi është rritja e integritetit të Policisë së Kosovës, ku secili zyrtar policor të jetë me integritet të lartë.

Synoj ta bëj një reformë të strukturës organizative, mirëpo kjo kërkon një analizë të detajuar të nevojave dhe të zhvillimit të rrethanave. Pastaj synoj një reformim të administratës, meqenëse konsideroj se e kemi një administratë mjaft të ngarkuar. Do ta bëj një decentralizim të personelit, gjithmonë duke konsideruar se në nivelin qendror ka një numër mjaft të madh të personelit, ndërsa konsideroj se personeli më i madh duhet të jetë në stacione policore, atje ku kryhen shërbimet dhe ku është kontakti i parë me qytetarin. Synim tjetër imi është të rritet transparenca në të gjitha fushat, atje ku është e nevojshme.

Në plan të parë kam rritjen e transparencës me organet e rekrutimit, pastaj rritjen e transparencës në promovim dhe rritjen e transparencës me mediet. Synimi im është që zyra jonë për medie të punojë deri në orën 24:00. Në mënyrë

që sa herë që kanë nevojë mediet ta kontaktojnë policinë dhe të ketë çdoherë zyrtarë të policisë që janë në detyrë për t'ua ofruar informatat e nevojshme medieve. Natyrisht se ndër objektivat e mia kryesore është t'i luftojmë të gjitha llojet e krimin, duke u fokusuar në krimin ekonomik, korrupsionin dhe krimin e organizuar. Kur flas për krimin e organizuar nënkuptoj të gjitha llojet e trafikëve, të drogave, të njerëzve e kështu me radhë.

Në këtë drejtim mendojmë t'i ngrehim kapacitetet në krime kibernetike, meqenëse sot krimi kibernetik është një kërcënim serioz si pasojë e globalizimit. Pra, Policia e Kosovës ka nevojë t'i ngrehë kapacitetet në këtë fushë, si dhe në menaxhimin e materialeve të rrezikshme. Këto janë synimet e mia kryesore. Policia e Kosovës është mjaft profesionale, por ne do të vazhdojmë të punojmë që ta bëjmë edhe më të mirë këtë institucion.

**"Epoka e re":** Ky institucion të enjten ka shënuar 19-vjetorin e themelimit. Cilat janë sfidat kryesore me të cilat po përballlet policia?

**Qalaj:** Besoj se ky institucion me krenari ka shënuar 19-vjetorin e themelimit. Deri këtu ka ardhur falë një punë të madhe dhe mbështetjes së shumë institucioneve vendore dhe ndërkombëtare si dhe partnerëve strategjikë, që edhe sot po vazhdojnë të na mbështesin. Në fjalimin tim, në ceremoninë zyrtare, i falënderova të gjithë ata që kanë kontribuar që Policia e Kosovës të jetë në këtë shkallë të profesionalizmit ku është tani. Policia e Kosovës ka mjaft sfida me të cilat po përballlet. Një sfida e rëndësishme është që zyrtarët tanë policorë nuk kanë sigurim shëndetësor, dhe ne sot kemi një moshë mjaft të vjetër të policëve, ku moshja mesatare shkon 44.66 vjet. Këto dy sfida kërkojnë implikime buxhetore dhe ne shpresojmë në mirëkuptimin e Qeverisë. E

# dhe integritetin në polici



he kohore do të mund t'i përmbushni këto dy kërkesa?

**Qalaj:** Ne kemi mirëkuptim të Qeverisë për këto çështje. Tashmë Qeveria e ka proceduar në Kuvend Projektligjin për paga, i cili u siguron paga të dinjitetshme zyrtarëve policorë. Besoj se në ditët në vazhdim edhe çështja e pensionimit do të diskutohet. Ne do të jemi fleksibilë dhe do ta shikojmë mundësinë më të mirë të mundshme që të jemi të kujdesshëm edhe për buxhet. Ne nuk kërkojmë që pensionimi të jetë i menjëhershëm, por atë ta bëjmë me etapa, për disa vjet, në mënyrë që procesi i pensionimit të shkojë përpara dhe buxheti të mos ngarkohet shumë. Ndërsa për sigurimin shëndetësor besoj se do të gjendet një zgjidhje për të gjithë, jo vetëm për Policinë e Kosovës. E di që do të jetë i vështirë realizimi i këtyre kërkesave, por shpresoj se do të gjejmë një zgjidhje. Ne jemi duke menduar edhe zgjidhjet alternative, meqenëse nuk mund të qëndrojmë një kohë të gjatë pa sigurime. Ndoshta me ndonjë kompani private besoj se do ta gjejmë një zgjidhje.

**"Epoka e re":** Që disa vjet Policia e Kosovës synon të bëhet pjesë e Interpolit. Anëtarësimi në këtë organizatë sa do ta ndihmonte këtë institucion për kryerjen e përgjegjësi?

**Qalaj:** Në këtë drejtim është një përpjekje e të gjithëve, duke filluar prej Qeverisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, policisë, Kuvendit dhe shoqërisë civile. Pra, synimi i të gjithëve është që sa më shpejt të pranohemi në Interpol dhe më vonë në Evropol. Besoj se i kemi gjasat mjaft të mira kësaj here, ani pse nuk do të jetë lehtë. Kjo rrugë ka shumë sfida. Ju me siguri jeni në dijeni për fushatën e Serbisë kundër anëtarësimit të Kosovës në institucione ndërkombëtare. Personalisht mendoj se anëtarësimi i Kosovës në Interpol më shumë i konvenon Interpolit, meqenëse për momentin jemi vetëm konsumues të sigurisë. Po të ishim anëtarë edhe ne do të kontribuonim me informatat tona në luftimin e të gjitha dukurive negative: si atyre të migrimit ilegal, të dokumentacionit, të gjurmëve të gishtit dhe të njerëzve që janë në listat e kuqe. Pra, interesi është i ndërsjellë dhe besoj se ne do të bëhemi anëtarë. Ne edhe sot komunikojmë me Interpolin përmes zyrës së UNMIK-ut, por është ndryshe kur ke qasje të drejtpërdrejtë. Kjo do ta na ndihmonte shumë në luftimin e krimin.

**"Epoka e re":** Pra, jeni optimistë se brenda këtij viti Kosova do të bëhet anëtare e Interpolit?

**Qalaj:** Normalisht se jemi optimistë, sepse është punuar mjaft shumë në këtë drejtim. Kemi edhe një mbështetje nga faktori ndërkombëtar, pra nga partnerët tanë. Ende na duhet shumë punë, por besoj shumë se do të kemi sukses.

**"Epoka e re":** Pavarësisht prej vlerësimeve pozitive vendore dhe ndërkombëtare për policinë, disa subjekte politike vazhdojnë ta kritikojnë këtë institucion si të kapur. Cili është përgjigja juaj ndaj këtyre kritikave?

**Qalaj:** Për profesionalizmin e Policisë së Kosovës nuk është bërë vetëm një hulumtim, por janë bërë disa hulumtime të tilla vendore dhe ndërkombëtare që Policinë e Kosovës e vendosin bukur lart në krahasim me vendet e rajonit. Po ashtu, në bazë të këtyre hulum-

timeve policia në aspektin e besueshmërisë gjendet bukur larg nga institucionet e tjera vendore. Kjo tregon se Policia e Kosovës është një polici e zhvilluar dhe e trajnuar, e cila i kryen të gjitha përgjegjësit ashtu si duhet. Nuk dua as të mendoj se policia është e përkryer, mirëpo ne jemi duke punuar shumë që të ofrojmë shërbime sa më të mira për qytetarin. Vetë fakti se ne synojmë të ofrojmë shërbime sa më të mira për qytetin, atëherë sigurisht se do ta rrisim besimin edhe më shumë. Zërat kritikë ndaj Policisë së Kosovës nuk dua t'i komentoj, meqenëse çdokush ka të drejtë të mendojë si të dëshirojë. Nëse vërejnë gabime te policia, është normale edhe të na kritikojnë. Besoj se nga kritikantët do të mësojmë dhe do të bëhemi më profesionalë. Por, nuk dëshiroj të besoj se Policia e Kosovës kritikohet në bazë të agjendave të ndryshme partiake.

**"Epoka e re":** Reagime ka pasur edhe kundër juve kur jeni emëruar drejtor i Policisë. Si do t'ua ktheni besimin këtyre individëve?

**Qalaj:** Sigurisht se besimin e atyre në Policinë e Kosovës do ta kthejmë me punë profesionale. Dëshiroj të them se emërimi im ka qenë në një proces konkurrues dhe transparent. Për këtë pozitë kanë garuar 17 persona, prej tyre 13 kanë hyrë në listën e ngushtë, duke iu nënshtruar proceseve të intervistimit. Siç dihet, vlerësimin tonë e ka bërë një panel vendor dhe ndërkombëtar. Mendoj se ky proces ka qenë shumë i rregullt dhe transparent. Është e drejtë e çdokujt të kritikojë. Mua, menaxhmentit dhe kolegëve të mi na mbetet të punojmë shumë në mënyrë që të ofrojmë shërbime sa më të mira për qytetarët dhe të luftojmë çfarëdo lloj krimi. Ky është synimi ynë kryesor.


## UP-ja ngjitet lart në radhitjen më botërore të universiteteve

EPOKA  
ERE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" sërish ka treguar progres të rëndësishëm në radhitjen botërore të universiteteve dhe kolegjeve të Webometrics. Në këtë radhitje, së cilës i nënshtrohen më tepër se 12 000 universitete nga mbarë bota, universiteti publik më i rëndësishëm i Kosovës për një kohë relativisht të shkurtër ka lëvizur në pjesën më të lartë të renditjes së universiteteve botërore. Katër vjet më parë Universiteti i Prishtinës zinte vendin e 4 937 në këtë ranglistë, ndërsaq këtë vit UP-ja u ngjit në pozicionin e 2 429.

Rektori i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", prof. dr. Marjan Dema, e sheh këtë lëvizje pozitive në radhitjen e Webometrics si rezultat i reformave të fundit në këtë institucion. "Edhe pse UP-ja ka shumë punë derisa të mund të konsiderohet një ndër më të mirët në botë, është kënaqësi ta shohësh këtë progres, i cili konfirmon përpjekjet tona për reforma në vitet e fundit", ka thënë Dema. Një reformë e rëndësishme së cilës UP-ja ia atribuon ngritjen në



këtë radhitje është zhvillimi i sistemit hulumtues të bazuar kryesisht në praktikat e universiteteve publike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku një ndihmesë të madhe në këtë drejtim e ka dhënë Programi i Transformimit të Liderit - Bursave dhe Partneriteteve - projekt i përbashkët i USAID-it dhe Qeverisë së Kosovës. Ashtu sikurse në pothuajse të gjitha universitetet amerikane, UP-ja tani ka themeluar dhe funksionalizuar Zyren për Projekte dhe Programe të Sponsorizuara (ZKPS), e cila e ka për detyrë t'i mbështesë hulumtuesit në përpjekjet e tyre për të fituar grante dhe në menaxhim të fondeve për hulumtime shkencore nga jashtë. Sipas prorektorit për kërkime

shkencore në UP, prof. dr. Faton Berisha, UP-ja pret progres në dy vjetet e ardhshëm, për faktin se ZKPS-ja tashmë është duke u pajisur me staf. "Ne do të bëjmë edhe më tepër për ta motivuar stafin akademik për të realizuar hulumtime", ka deklaruar Berisha.

Ngritja e hulumtimit shkencor në nivel të njësive akademike ndikon drejtpërdrejt në radhitjen e UP-së jo vetëm në Webometrics, por edhe në ranglistat e tjera të universiteteve. Webometrics në mënyrë unike përdor analizimet e linçeve të cilat ata citojnë për të ofruar një vlerësim më kualitativ, i cili konsiderohet mjet më i fuqishëm sesa analiza e citimit ose anketat globale.

**"Epoka e re":** Cila do të jetë qasja juaj në adresimin e këtyre dy sfidave? Brenda çfarë periud-

Kryesia e Kuvendit ka vendosur që më 13 shtator t'i vazhdojë punimet e seancës plenare, të datës 30 korrik 2018, me pikat e mbetura

# Nuk arrihet unitet për dialogun

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka mbledhur të enjten në takim kryetarët e grupeve parlamentare, ku është vendosur që më 13 shtator t'i vazhdojë punimet e seancës e radhës. Pavarësisht prej diskutimeve lidhur me dy seancat e jashtëzakonshme, të ndërprera në mungesë të kuorumit, kryesia nuk nxori ndonjë vendim. Veseli pas mbledhjes së kryesisë ka thënë se nuk do të mungojë uniteti i palës së Kosovës në bisedimet me Serbinë, pavarësisht prej ndasive që ekzistojnë aktualisht e që, sipas tij, po përdoren nga partitë opozitare për çështje elektorale



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 6 SHTATOR** - Ka përfunduar pa asnjë marrëveshje të enjten takimi i thirrur nga kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, me kryesinë e Kuvendit dhe shefat e grupeve parlamentare. Partitë në pushtet dhe ato në opozitë nuk kanë lëvizur nga pozicionet fillestare. Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, pas mbledhjes së kryesisë ka thënë se nuk do të mungojë uniteti i palës së Kosovës në bisedimet me Serbinë, pavarësisht prej ndasive që ekzistojnë aktualisht e që, sipas tij, po përdoren nga partitë opozitare për çështje elektorale. "Deri në momentin kur qetësohen gjakrat dhe ulen tensionet, atëherë do ta kemi një rezolutë. Më 13 shtator, në seancën e parë të sesionit

vjeshtor të Kuvendit, në pikën e gjashtë të rendit të ditës, është një rezolutë për dialogun me Serbinë e propozuar nga PSD-ja. Kjo është një mundësi për ta adresuar shqetësimin real të opozitës", ka thënë Veseli. Ndërkaq shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, ka theksuar se kushti që e ka paraqitur kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, dëshmon se ky koalicion qeverisës i ka zaptuar institucionet e Kosovës. "Kushti i kryetarit të Kuvendit është të sigurohen 61 vota në sallë dhe ky propozim është metodë për bllokim të Kuvendit", është shprehur Hoti. Sipas tij, opozita nuk po arrin ta ketë shumicën në Kuvend, prandaj e ka të pamundur ta zhvillojë seancën ku do të votohej rezoluta për bisedimet me Serbinë. Shefi i grupit parlamentar i

Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, ka thënë se është e pakuptueshme se si kryeministri, Qeveria dhe deputetët e partive në pushtet nuk janë të pranishëm në sallën e Kuvendit. "Nuk ka askund në botë ku Qeveria e bojkoton Kuvendin. Kjo Qeveri e ky pushtet duhet të japin dorëheqje dhe vendi të shkojë në zgjedhje. Në momentin kur mazhoranca nuk guxon të vijë me opozitën t'i përballë numrat në Kuvend, kjo do të thotë se pushteti nuk ndihet i sigurt në numrat e vet. Pse nuk vjen mazhoranca për shembull sot, sepse mendon se kur opozita t'i formulojë ato pikat e veta që janë mbrojtja e kufijve të Kosovës dhe moscenimi i territorit të Kosovës, mendon se ndodhej në një situatë

të keqe dhe ndoshta edhe ndonjë deputet i saj do t'ia jepte votën kësaj rezolute. Për ta pamundësuar këtë, ata e aplikojnë bojkotin total", ka thënë Konjufca. Shefi i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka thënë se këto ditë është shpërfaqur realiteti se për çështje kombëtare as mazhoranca dhe as opozita nuk mund ta bartin procese të rëndësishme vetë. Ai ka pohuar se për çështjen e dialogut të gjithë duhet të bëhen bashkë. "Gjashtë liderë të partive politike të mazhorancës dhe të opozitës duhet të bëhen bashkë, të ulen dhe t'i japin një përgjigje kësaj çështje dhe të mos ta hedhin topin te deputetët. Deputetët janë të detyruar t'i ndjekin udhëzimet e

vendimet e partive politike", ka thënë Sherifi. Dy seancat e jashtëzakonshme të thirrura, njëra nga pozita e tjetra nga opozita, nuk kanë arritur të mbahen për shkak se asnjëra palë nuk po arrin t'i mbledhë në sallën e seancave 61 deputetë. Kryeministri Ramush Haradinaj ka pranuar se, pos opozitës, as Lista Serbe, që është partnere e koalicionit, nuk po e voton propozimin e tij për ekipin negociator të Qeverisë për dialogun me Serbinë. Ndërsa as opozita nuk ka arritur t'i mbledhë të mërkurën dhe të enjten 61 vota për seancën që kishte thirrur me qëllim të votimit të një rezolute që ndalon negociimin për kufij në dialogun me Serbinë.

## Stabilizohet furnizimi me barna në QKUK

Të dhënat në ditët e fundit nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitari i Kosovës (QKUK-ja dhe spitalet e përgjithshme) tregojnë se furnizimi me barna në këtë shërbim është mbi 70 për qind

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 6 SHTATOR** - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka njoftuar se si rezultat i angazhimeve konkrete, ngritjes së përgjegjësisë në menaxhimin e parasë publike dhe vendosjen e rregullit në sektorin farmaceutik, në institucionet publike shëndetësore ka përmirësim të vazhdueshëm të furnizimeve me barna dhe material shpenzues. Të dhënat në ditët e fundit nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitari i Kosovës (QKUK dhe spitalet e përgjithshme) tregojnë se furnizimi me barna në këtë shërbim është mbi 70 për qind. Gjithashtu, ka një përmirësim edhe në furnizimin me material

shpenzues dhe citostatikë, të cilët, së fundi, po blihen nga MSh-ja me çmime më të ulëta sesa që janë blerë në të kaluarën. Procesi i përmirësimit të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm me barna është duke vazhduar dhe këtë e siguron edhe lidhja së fundi e shumë kontratave të reja nga ana e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore për nevoja të institucioneve publike shëndetësore. Ministria e Shëndetësisë, krahas sigurimit të furnizimeve të reja me çmime të volitshme dhe ndërprerjes së dukurive abuzive me buxhetin e dedikuar për barna dhe material shpenzuese, ka filluar edhe procesin e revidimit të Listës së Barnave Esenciale, me qëllim që pacientëve kosovarë t'u mundëso-



het qasje në terapitë e reja dhe cilësore dhe në përputhje me praktikën më të mira farmaceutike. MSh-ja do të vazhdojë ta ketë prioritet ngritjen e nivelit të furnizimit, krahas rritjes së performancës

në menaxhimin e sektorit farmaceutik, me të vetmin qëllim që pacientëve t'u sigurohet terapi e sigurt, me kohë dhe njëkohësisht të kursethet edhe paraja publike siç është dëshmuar me funksionaliz-

imin e shërbimeve të reja në QKUK përmes sigurimit të pajisjeve bashkëkohore, shërbime këto të cilat buxhetit të vendit i kanë kursyer së fundi qindra mijëra euro.

# Kosova e gatshme të marrë pjesë në misione paqeruajtëse

Zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Burim Ramadani, ka bërë me dije se tashmë Republika e Kosovës është e gatshme të marrë pjesë në misione paqeruajtëse. Ai ka thënë se së bashku me NATO-n, Kosova synon ta mbështesë paqen, sigurinë dhe stabilitetin në zona të ndryshme të botës. Këto komente Ramadani i ka bërë në tryezën e organizuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), ku është thënë se MSA-ja mundëson pjesëmarrjen e Kosovës në operacionet dhe misionet paqeruajtëse



EPOKA  
ERE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Kosova është e gatshme të marrë pjesë në misione paqeruajtëse. Kështu ka thënë të enjten zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Burim Ramadani, në tryezën e organizuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS). Ai ka thënë se Kosova synon ta mbështesë paqen, sigurinë dhe stabilitetin në zona të ndryshme të botës. "Kosova është e gatshme të marrë pjesë në misione paqeruajtëse. Me NATO-n apo shtetet anëtare, Kosova synon të mbështesë paqen, sigurinë dhe stabilitetin në zona të ndryshme të botës. Tregimi është ky: Një popull i vogël që është shpëtuar për shkak të ndërhyrjes së botës demokratike, pas 20 vjetësh i bashkohet pikërisht botës demokratike për ta ndihmuar paqen, sigurinë dhe stabilitetin në zona të tjera të krizës. Bashkë me NATO-n", ka deklaruar Ramadani. Ai ka theksuar se institucionet e Kosovës kanë punuar në mënyrë sistematike për ndërtimin e fazës së re për Forcën dhe Sigurisë së Kosovës, i cili është misioni ushtarak dhe mbrojtës. "Për FSK-në kemi arritur sukses të plotë në

komunitetin e brendshëm dhe me komunitetet joshumicë që jetojnë në Kosovë. FSK-ja ka vazhduar gjithnjë të jetë ushtri multifunkionale dhe shumetnike", është shprehur Ramadani, duke shtuar se Kosova nuk ka asnjë plan politik për zëvendësimin e misionit të KFOR-it në Kosovë apo praninë e NATO-s. "Përkundrazi, ne e shohim se tranzicioni i FSK-së është vetëm vlerë e shtuar dhe partneritet bashkë me praninë e NATO-s në Kosovë dhe KFOR-in si organizatë", ka deklaruar ai.

Ramadani ka treguar se në të ardhmen do të dyfishohet numri i pjesëtarëve të FSK-së. Në këtë tryezë është prezantuar raporti me temë "Pjesëmarrja e Kosovës në misionet paqeruajtëse: një mjet efektiv për politikën e jashtme" i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), i cili shqyrton mundësitë e ofruara nga MSA-ja si një rrugë potenciale për pjesëmarrjen e Kosovës në operacionet dhe misionet paqeruajtëse të BE-së. Sipas QKSS-së, izolimi aktual i Kosovës dhe mungesa e rrugës së qartë për anëtarësim në organizatat dhe mekanizmat ndërkombëtare të sigurisë jo vetëm se e kanë penguar vendin për t'u bërë pjesë e infrastrukturës globale të sigurisë, por kanë ulur edhe

shanset për të marrë pjesë në misionet paqeruajtëse në mbarë botën. "Edhe në ato raste kur këto perspektiva duken të mundshme, potenciali i Kosovës për të marrë pjesë në mekanizmat e sigurisë të BE-së nëpërmjet Politikës së Përbashkët të Mbrojtjes dhe Sigurisë së BE-së, siç është paraparë me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, është tkurrur më tej nga refuzimi i pavarësisë së Kosovës nga pesë vendet anëtare të BE-së", është thënë në komunikatë. Sipas QKSS-së, MSA-ja i ofron Kosovës një momentum që ta fillojë dialogun politik për pjesëmarrjen në operacionet dhe misionet paqeruajtëse. Mungesa e konsensusit në BE lidhur me pavarësinë e Kosovës së bashku, me faktin se pesë shtete anëtare të BE-së nuk e njohin Kosovën, e bëjnë të pamundur që BE-ja të insistojë në pjesëmarrjen e Kosovës në misionet paqeruajtëse. "Prandaj, kjo kërkon qëndrim

më të fuqishëm nga Ministria e Punëve të Jashtme në shtyrjen e një dialogu të politikës në lidhje me këtë çështje. MSA-ja i mundëson Kosovës ta nisë dialogun e politikave për siguri dhe mbrojtje përmes Komitetit të Stabilizim Asociimit. Si përgjigje, Qeveria e Kosovës duhet të hartojë dokumente për ta lidhur politikën e jashtme të Kosovës me të BE-së, veçanërisht për sa iu përket operacioneve dhe misioneve paqeruajtëse. Ligjet e Kosovës inkurajojnë pjesëmarrjen e vendit në operacione dhe misione paqeruajtëse. Megjithatë, në përputhje me infrastrukturën aktuale të sigurisë të Kosovës, korniza ligjore rregullon pjesëmarrjen e trupave të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në misione paqeruajtëse, por ligjet nuk adresojnë dërgimin e kapaciteteve civile në operacione të tilla", është theksuar në komunikatë. Sipas QKSS-së, për shkak të

rritjes së rëndësisë së misioneve civile të BE-së duhet të hartohet korniza legislative që rregullon dërgimin në misionet civile. "Paralelisht me kornizën ligjore, FSK-ja duhet ta vazhdojë trajnimin e saj themelor për operacionet e kërkimit dhe shpëtimit, kontrollin dhe pastrimin e materialeve të rrezikshme, asgjësimin e armëve dhe eksplozivëve, zjarfikës dhe detyra të tjera humanitare dhe paqeruajtëse, në mënyrë që të jetë e përgatitur për të shërbyer në operacione dhe misione të tilla. Institucionet e Kosovës duhet ta theksojnë natyrën teknike të pjesëmarrjes së Kosovës në misionet e Politikës së Përbashkët për Siguri dhe Mbrojtje (PPSM) si mënyrë e tejkalimit të ndarjeve të brendshme të BE-së lidhur me pavarësinë e Kosovës, ashtu siç bëri BE-ja gjatë sjelljes së misionit të PPSM-së, EULEX, në Kosovë", është thënë në komunikatën e QKSS-së.

## Vetëvendosja fton LDK-në për organizim të protestave kundër Thaçit


PRISHTINË, 6 SHTATOR (ER) - Kryesia e Lëvizjes Vetëvendosje ka mbajtur të enjten mbledhje të jashtëzakonshme të udhëhequr nga kryetari Albin Kurti, në të cilën është shqyrtuar gjendja politike në vend. Pas diskutimeve të anëtarëve të Kryesisë së LV-së u mor vendim për t'i bërë ftesë Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për organizimin e përbashkët të protestave.

Nga kryesia e Vetëvendosjes janë ngarkuar kryetari i kësaj lëvizje, Albin Kurti, nënkryetari Besnik Bislimi, nënkryetarja Fatmire Mulhaxha-Kollçaku dhe kryetari i

grupit parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje Glauk Konjufca, që të vendosin kontaktet dhe të zhvillojnë takim me udhëheqjen e LDK-së. "Është e nevojshme që më së largu nesër të përcaktohet data e protestës", është thënë në komunikatën e Lëvizjes Vetëvendosje.

Sipas Lëvizjes Vetëvendosje, "presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, pa mandat të Kuvendit po vrapon në negociata pa parime me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Ne nuk mund të lejojmë pazare me sovranitetin, territorin dhe kufijtë e Kosovës. Aventura personale e

presidentit të Kosovës është e papranueshme. Ai po i mashtron qytetarët e Kosovës dhe ata të Kosovës Lindore. Prandaj ai duhet të largohet. Qeveria e pakicës po e bojkoton Kuvendin e Republikës. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, duhet të dorëhiqet. Vendi duhet të shkojë në zgjedhje të reja parlamentare. Kërkojmë zgjedhje të lira, demokratike dhe të ndershme. Nevojitet legjitimitet i ri i një qeverie të re", është theksuar në komunikatën e Lëvizjes Vetëvendosje. Sipas LV-së, institucionet e Kosovës nuk po funksionojnë. "Kuvendi është



blokuar. Presidenti i Serbisë do të vijë në Kosovë këtë fundjavë, por Qeveria dhe Policia e Kosovës nuk do ta arrestojnë atë. 'Zajednica'

Thaçi - Vuçiq është evidente. Presidenti i Serbisë nuk duhet lejuar të hyjë në Kosovë", është theksuar në komunikatën e LV-së.



## Haradinaj i kënaqur me dinamikën e punës në autostradën 'Arbën Xhaferi'

PRISHTINË, 6 SHTATOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka vizituar të enjten punimet në Autostradën "Arbën Xhaferi", Prishtinë - Hani i Elezit, përkatësisht në hyrje të Hanit të Elezit, segmenti B406-407, ku është duke u ndërtuar një prej urave më të mëdha në rajon në gjatësi prej 6 km.

Kryeministri Haradinaj, i cili shoqërohej edhe nga ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka thënë se është i kënaqur me dinamikën se si po zhvillohen punimet në këtë segment, derisa ka theksuar se është i bindur që punimet në fjalë janë nën angazhimin e kompanisë më të sigurt në botë. "Jemi sot bashkë me ministrin Lekaj në

punishte, ku po punohet rruga 6. Jemi të bindur se kjo punishte është në duart me të sigurt në botë, njerëzit më kompetentë. E mira është se janë katër mijë njerëz që punojnë. Janë qindra kompani të Kosovës të kontraktuara me njerëz të Kosovës që punojnë dhe do të përfitojnë nga kjo përvojë", ka thënë kryeministri

gjatë inspektimeve të punimeve. Ndërkaq drejtori i projektit të kompanisë "Bechtel Enka", Riyadh Alkawazayi, e ka falënderuar kryeministrin që mori pjesë në inspektimet e punimeve në këtë segment të autostradës dhe për interesimin e tyre për t'i parë nga afër zhvillimet. Ai ka pohuar se

është i lumtur që t'i tregojë kryeministrin për progresin, i cili personalisht është angazhuar për mbarëvajtjen dhe angazhimin e këtij projekti. Kryeministri Haradinaj ka kërkuar të vazhdohet me dinamikën e punimeve të deritashme dhe që punimet të përfundojnë para ndërrimit të moteve.



## Kosova përballet me shkallë të lartë të papunësisë

PRISHTINË, 6 SHTATOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Skender Reçica, ka pritur në takim përfaqësues të GIZ-DIMAK (Qendra Gjermane e Informacionit për Migracionin, Aftësim dhe Karrierën), me të cilët ka biseduar rreth punësimit të të rinjve, me theks të veçantë zgjerimit të mundësive për migrim legal për punësim dhe aftësim profesional të të rinjve në vendet e BE-së, në këtë rast në

Gjermani. Me këtë rast, ministri Reçica ka vlerësuar punën e deritanishme të GIZ-DIMAK në orientimin dhe këshillimin e qytetarëve për migrim si dhe ka vlerësuar bashkëpunimin mes GIZ-it dhe MPMS-së, duke kërkuar që ky bashkëpunim të fuqizohet edhe më shumë, sidomos rreth punësimit sezonal të qytetarëve të Kosovës. "Kosova përballet me shkallë të lartë të papunësisë për çka MPMS, së

bashku me partnerët e saj siç është GIZ, po bën përpjekje maksimale për zbutje të kësaj gjendje", ka thënë Reçica. Ai ka theksuar se një nga nevojat kryesore sa i përket punësimit është orientimi i të rinjve në karrierë për shkak se Kosova po përballet me mospërputhje të aftësive profesionale me nevojat e tregut të punës. "Një zgjidhje afatshkurtër do të ishte angazhimi i të rinjve tanë për punë

sezonale dhe të përkohshme në vendet e BE-së. Fuqia punëtore e kualifikuar sipas standardeve të BE-së do të mund t'i nxiste investimet e huaja në Kosovë, sepse do të gjenin fuqi punëtore të kualifikuar dhe më të lirë se vendet e BE-së", është shprehur Reçica. Ndërsa udhëheqësja e GIZ-DIMAK në nivel qendre në Gjermani, Nina Theis, ka falënderuar ministrin për bashkëpunim. Ajo ka shprehur

pajtimin e plotë që orientimi në karrierë i të rinjve është një çështje për të cilën duhet fokusuar në projektet e ardhshme në mes të GIZ-it dhe MPMS-së. Theis ka theksuar se GIZ-i do të ofrojë gjithë ndihmën e nevojshme për ta mbështetur MPMS-në dhe Agjencinë e Punësimit sa i përket zbutjes së papunësisë, sidomos për dhënien e mundësisë për migrim legal për punësimin e qytetarëve të Kosovës.



# Mehmeti: BQK-ja po përmbush standardet ndërkombëtare të rregullativës financiare



**EPOKA ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 6 SHTATOR** - "Dinamika me të cilën po zhvillohet rregullativa financiare ndërkombëtare kërkon resurse të konsiderueshme për t'u zbatuar nga bankat qendrore dhe kjo sigurisht se paraqet një sfidë të rëndësishme për bankat qendrore më të vogla siç janë BQK-ja dhe bankat e tjera të rajonit tonë", ka deklaruar guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, në punëtorinë me temën "Ballkani perëndimor: Reformat rregullatore bankare dhe zbatim i tyre - sfidat përpara", e organizuar bashkërisht nga BQK-ja dhe GIZ-i gjerman.

Mehmeti ka theksuar se përmes organizimeve të tilla BQK-ja do të

jetë në gjendje t'i bashkojë energjitë dhe përvojat në mënyrë që të jenë sa më efektiv në ndjekjen dhe zbatimin e standardeve më të mira ndërkombëtare. "Për një sistem bankar të ri si Kosova, sigurisht se zbatimi i kërkesave të Basel III, IFRS 9 dhe zbatimi i procedurave të rregullta për likuidimin e bankave (Bank Resolution) ka qenë dhe është mjaft sfidues. Megjithatë, me përkrahjen e partnerëve tanë ndërkombëtarë kemi arritur progres të konsiderueshëm dhe sot rregullativa jonë financiare po arrin ta mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të sistemit financiar të vendit", ka deklaruar Mehmeti. Ai ka shtuar se BQK-ja ashtu edhe si bankat e tjera qendrore të rajonit me kohë ka vendosur si prioritet shumë të rëndë-

sishëm zbatimin e vazhdueshëm të standardeve më të mira ndërkombëtare në fushën e rregullativës financiare.

Mehmeti ka thënë se sektori bankar i Kosovës mbetet një ndër sektorët më të suksesshëm dhe me trend të vazhdueshëm të rritjes. "Edhe gjatë vitit 2018 sektori bankar vazhdon të tregojë qëndrueshmëri të komponentëve përbërës të likuiditetit, profitabilitetit dhe kapitalit. Sipas të dhënave të fundit të muajit qershor 2018, vlera e gjithsejtë mjeteve të sektorit bankar arriti në 3.9 miliardë euro, derisa struktura e mjeteve vazhdoi të financohet kryesisht nga depozitat dhe të jetë e përqendruar në aktivitetin e kredihënies. Vlera e përgjithshme e kredive të sektorit bankar në qershor 2018 ishte rreth 2.7 miliardë

euro, e cila paraqet një rritje vjetore prej 11.3 përqindësh. Treguesi i kredive joperformuese u zvogëlua në 2.8 për qind në fund të muajit qershor nga 3.9 për qind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, gjë që tregon për një afarizëm mjaft të shëndoshë të bankave që operojnë në vendin tonë. Gjithsejtë depozitat evidentojnë rreth 3.1 miliardë euro, ndërsa gjendja e likuiditetit të sektorit bankar vazhdon të jetë e qëndrueshme. Raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve me afat të mbetur deri në një vit përlogaritet 33.2 për qind, i cili evidentohet lart mbi kërkesën rregullative prej 25 përqindësh. Sektori bankar vazhdon të jetë mirë i kapitalizuar. Treguesi i kapitalit të bazuar në rrezik në muajin qershor 2018 ishte 17.4 për qind, që është lart

mbi kërkesën rregullative të BQK-së prej 12 përqindësh", ka thënë Mehmeti.

Të pranishmit e shumtë nga vendi dhe nga rajoni kanë marrë informatat e fundit për kuadrin rregullator ndërkombëtar për bankat që njihen si Bazel 3 dhe ndryshimeve në të ardhmen e këtij kuadri. Gjithashtu, janë diskutuar edhe sfidat e bankave të Ballkanit Perëndimor për t'i realizuar reformat dhe zbatimin e rregullativave si dhe direktivat e BE-së për sektorin bankar.

Në këtë punëtori, e cila do t'i vazhdojë punimet edhe të premtën, do të prezantohen edhe zyrtarë të Bankës Qendrore Evropiane, të Fondit Monetar Ndërkombëtar, BAFIN, Deutsche Bundesbank dhe disa bankave të vendeve të tjera anëtare të BE-së.

## Telekomi ofron internet të shpejtë për Spitalin e Përgjithshëm në Pejë

**PRISHTINË, 6 SHTATOR (ER)** - Kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Gent Begolli, është prituri të enjten nga drejtori ekzekutiv i Spitalit të Përgjithshëm në Pejë, Skender Dreshaj, me të cilin kanë lidhur marrëveshje për ofrimin e internetit të shpejtë në hapësirat e këtij spitali. Sipas kësaj marrëveshje,

Telekomi i Kosovës do të ofrojë 31 lidhje të internetit të shpejtë (WiFi), TiKon 50 Mbps, në hapësirat e këtij spitali, ndërsa instalimi do të bëhet duke përdorur teknologjinë e avancuar të fijeve optike GPON.

Kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Gent Begolli, u shpreh tejet i kënaqur me arritjen e kësaj

marrëveshje me Spitalin e Përgjithshëm në Pejë. Telekomit i Kosovës, Vala, do ta vazhdojë përmbushjen e synimeve strategjike për t'i plotësuar nevojat e të gjithë konsumatorëve, institucioneve publike dhe atyre private për qasje sa më të lehtë në shërbimet e internetit, telefonisë mobile, fikse dhe IPTV-së.



## Gashi fton kompaninë "Valgo" për investime në Kastriot

KASTRIOT, 6 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Kastriotit, Xhafer Gashi, me bashkëpunëtorë, ka pritur në takim një delegacion të kompanisë "Valgo" nga Franca, i udhëhequr nga menaxheri Antonio Passarelli. Gashi ka informuar përfaqësuesit e kësaj kompanie për situatën në të cilën gjendet Komuna e Obiliqit.

Më tutje, Gashi ka diskutuar

me mysafirët për mundësinë e bashkëpunimit për trajtimin dhe përmirësimin e ajrit, ujërave të zeza dhe tokës së kontaminuar në Komunën e Obiliqit. Kompania "Valgo" merret me trajtimin e ajrit, liqeneve dhe tokës, ku tokën e ndotur e pastron dhe e transformon në tokë pjellore, ndërsa shumicën e mbeturinave i përpunon dhe i transformon në energji eficiente.



## Vazhdojnë punimet për ndërtimin e 'Kanalit të Gështenjës'

DEÇAN, 6 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka bërë me dije se janë duke vazhduar punimet për rregullimin e kanalit të ujitjes në këtë komunë i cili do t'i ujisë katër

fshatra. "Po vazhdojnë punimet sipas dinamikave të parapara të kanalit të ujitjes 'Kanali i Gështenjës'. Përmes këtij kanali ujitjen tokat e fshatrave: Lëbushë, Isniq, Strellc i Epërm, Strellc i Ulët. Ky projekt

është bashkëfinancim i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Komunës së Deçanit, ndërsa menaxhimin e këtij projekti e ka kompania regjionale 'Hidro Drini', ka deklaruar Ramosaj.



## Universiteti 'Isa Boletini' përfiton projekt nga BE-ja

PRISHTINË, 6 shtator (ER) - Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" (UMIB) është përfitues i projektit "Innovative Teaching Education in Mathematics" nga programi i Bashkimit Evropian "Erasmus+ Capacity Building in the field of Higher Education". Në konzorcium janë universitetet partnere nga Greqia, Danimarka, Suedia, Austria, Izraeli, Republika Çeke, Uzbekistani dhe Maqedonia.

Menaxheri i këtij projekti në UMIB, prof. ass. dr. Faton

Merovci, ka thënë se ky projekt do t'i ndihmojë universitetit për zhvillimin profesional të stafit në lëndët "Algjebra Lineare" dhe "Kalkulus I", të cilat në UMIB kanë emërtimet "Matematika 1" dhe "Matematika 2". Sipas tij, në kuadër të projektit do të organizohen trajnime dhe vizita në universitetet partnere.

Mervoci ka theksuar se projekti do t'i ndihmojë profesorët e matematikës në zbatimin e teknikave të reja të mësimdhënies së matematikës dhe për-

gatitjen e materialeve nga këto lëndë nëpërmjet manualeve dhe videoligjëratave, ku studentët do të kenë qasje. "Ky projekt do të ketë impakt jo vetëm se si do të ligjërohet matematika në UMIB, por se si lëndët e tjera do të dizajnohen dhe prezantohen te studentët", ka thënë Merovci. Vlera e projektit që do të zgjasë tre vjet dhe që financohet nga Bashkimi Evropian, është gjithsejtë 999,557.00 euro, prej të cilave Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" do t'i realizojë 51,938.00 euro.

## Në Skenderaj konfiskohen produkte me afat të skaduar

SKENDERAJ, 6 SHTATOR (ER) - Inspektorët e Komunës së Skenderajt në kuadër të aktivitetit të vet ditor kanë kryer një kontroll rutinë në dyqanet e fshatit Çirez, ku kanë hasur gjera ushqimore me afat të skaduar. Pasi kanë verifikuar datën e afatit, inspektorët kanë kryer konfiskimin e mallit, vlera e të cilit është rreth 110 euro, duke e dërguar në një vend të izoluar, në të cilin e kanë asgjësuar.

Siç ka njoftuar Komuna e Skenderajt, pronarit të dyqanit tek i cili janë gjetur artikuj me afat të skaduar i është shqiptuar gjobë konform dispozitave ligjore.

Inspektorët nga Drejtoria e



Shërbimeve Publike e Komunës së Skenderajt ndërkaq kanë shtuar aktivitetin e kontrollimit të dyqaneve, marketeve dhe bizneseve në përgjithësi për ta parandaluar rrezikun e qytetarëve.

Komuna e Skenderajt ka bërë apel te pronarët e dyqaneve që shesin gjëra ushqimore, të jenë të kujdesshëm me produktet që shesin, kurse qytetarëve u është kërkuar bashkëpunim për t'i raportuar rastet e tilla.

## Vizitohen shkollat në Malishevë ku mësojnë nxënësit rom dhe ashkali

MALISHEVË, 6 SHTATOR (ER) - Anëtarët e Komitetit për Komunitete në Malishevë kanë vizituar tri shkolla në këtë komunë, në të cilat nxënësit rom dhe ashkali ndjekin mësimet e rregullta. Shkollat që janë vizituar janë Shkolla e Mesme e Lartë "Lagush Poradeci" në Kijevë, Shkolla Filllore e Mesme e Ulët "Kajtaç Ramadani" po në Kijevë dhe Shkolla Filllore e Mesme e Ulët "Naim Frashëri" në Banjë.

Anëtarët e këtij komiteti janë njoftuar nga drejtorët e këtyre shkollave për vijimin e nxënësve të



komunitetit rom dhe ashkali, për integrimin e tyre të plotë në sistemin arsimor, për trajtimin e barabartë si për të gjithë nxënësit, për krijimin e kushteve dhe për dhënien e mundësive të barabarta në mësimdhënien dhe mësimdhënien dhe aktivitete brenda e jashtë shkollës.

# SISTEMI ARSIMOR DHE LËNDËT SHOQËRORE!

Muhamet KRASNIQI

Pa dyshim se një prej shtyllave fundamentale të një shteti zhvillimor është arsimiti cilësor. Në Kosovë ka disa dekada që analfabetizmi është gjithnjë në zbehje, me tendencë drejt zhdukjes, ndërkohë që kemi edhe përpjekje të vazhdueshme për ngritje të cilësisë së arsimit. Këto janë sinjale të mira për një shoqëri që ende nuk e ka përmbyllur fazën e tranzicionit, veçanërisht kur realiteti i sotëm krahasohet me periudhën para Luftës së Dytë Botërore, në të cilën analfabetizmi ishte shtrirë tek shumica dërrmuese e popullsisë, por edhe kur krahasohemi me një pjesë të vendeve të pazhvilluara, të ashtuquajtura vende të Botës së Tretë. Megjithatë, duke qenë se aftësia krahasuese na mundëson që krahasimet t'i bëjmë në dy pole të kundërta, në këtë rast me shtetet e zhvilluara, atëherë edhe vetë ekzaltimi për realitetin që po çon drejt çrrënjosjes së analfabetizmit fillon të zbehet. Kjo për faktin se ne sot, sa i përket gjendjes në arsim, qëndrojmë shumë mirë në krahasim me të kaluarën tonë dëshpëruese dhe realitetin që e përjetojmë sot disa vende të pazhvilluara të kontinenteve të tjera por, megjithatë, nuk qëndrojmë mirë në raport me një numër të vendeve perëndimore, të cilat i kushtojnë një rëndësi shumë të madhe fushës së arsimit, i cili shihet si parakusht për zhvillimin e të gjithë sektorëve dhe fushave të tjera. Thjesht zhdukja e analfabetizmit që pritet të ndodhë në të ardhmen e afërt nuk mund të na mrekullojë, sepse ky është kalim i një pragu minimal në procesin e gjatë drejt zhvillimit shkencor dhe intelektual, prag të cilin vendet perëndimore e kanë kaluar shumë më herët.

Në fakt, me cilat vende dhe me cilat periudha duhet të krahasohemi realisht!? Natyrisht se njerëzit dhe shtetet janë të lira të krahasohen me kë të duan. Individët mund ta zbatojnë formulën e shpresës, ku për të mos u dëshpëruar mund të krahasohemi me ata që janë poshtë nesh, ndërsa për t'u motivuar të krahasohemi me ata sipër nesh. Por ky parim vlen qoftë në aspektin individual, qoftë në atë kolektiv. Edhe në kontekstualitetin politik pozita dhe opozita e secilit vend, pothuajse gjithnjë e gjejmë veten në pikëpamje kontradiktore në raport me njëra-tjetrën, ku në njërin anë pozita është e prirë që realitetin dhe arritjet, që janë edhe derivat i saj, t'i krahasojë me të kaluarën dëshpëruese dhe

dështimet e vendeve të pazhvilluara, ndërsa në anën tjetër opozita po të njëjtin realitet tenton ta krahasojë me arritjet e vendeve të zhvilluara, në mënyrë që kështu t'i arsyetojë vërejtjet e saj. Sidoqoftë, pavarësisht prej krahasimeve, realiteti mbetet po ai, ndërsa individët, komunitetet dhe institucionet publike dhe politike janë të thirrur që të gjithë ta ndryshojnë atë për së mbari.

Në Kosovë Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në vitin 2016 ka nxjerrë dokumentin e Kornizës Kurrikulare (KK) për arsimin parauniversitar dhe derivatin e saj Kurrikulën Bërthamë (KB) me tri nivelet e saj, dedikuar arsimit fillor, arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë. KK, ndër të tjera, me shumë të drejtë i ka përcaktuar gjashtë qëllime të përgjithshme të arsimit parauniversitar, të cilat janë të një rëndësie shumë të veçantë, sepse nënkuptojnë që parimet, kompetencat, planet dhe programet mësimore, çështjet ndërkurrikulare dhe jashtëkurrikulare, metodologjia, vlerësimi, fushat e kurrikulës, mësimdhënia dhe mësimnxënia të cilat janë pjesë përbërëse e KK dhe KB, janë në funksion të arritjes së këtyre gjashtë qëllimeve të përgjithshme, si në vijim:

"1. Kultivimi i identitetit personal, kombëtar, i përkatësisë shtetërore e kulturore; 2. Promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare; 3. Zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit; 4. Aftësi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore; 5. Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë për zhvillim të qëndrueshëm; 6. Aftësi për mësim gjatë gjithë jetës".

Këto qëllime janë shumë të drejta, të arsyeshme dhe në përputhje me kërkesat e nevojat e këtij shekulli të rrëmbyeshëm. Por ekzistojnë arsye të shumta, objektive dhe subjektive pse një numër të këtyre qëllimeve nuk po arrijn t'i realizojë arsimi parauniversitar, e që pa dyshim se njëra ndër to, e cila do të jetë fokus i kësaj trajtëse koncize, lidhet ngushtë me faktin se lëndët shoqërore që më së shumti dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë i përgjigjen shumicës së këtyre qëllimeve, fondin e orëve e kanë shumë të vogël ose disa prej tyre fare nuk janë përfshirë në planin programet e shkollave të profesionale. Qëllimet janë të larta, por mjetet e vogla i vështirësojnë arritjet e tyre!

Lëndët shoqërore nuk sjellin përfitime dhe rezultate të menjëhershme, siç ngjan me disa prej drejtimeve natyrore dhe profesionale, të ndërtimitarisë, mekanikës, bujqësisë, inxhinierisë dhe teknologjisë, sepse ndërtimi i një shoqërie kualitative me mentalitet që i ka për bazë tri parime të përgjithshme etike dhe ligjore: përgjegjësinë, ndershmërinë dhe llogaridhënien, kërkon kohë, vullnet, durim dhe përkushtim.

Ne kemi inxhinierë, doktorë dhe profesionistë të fushave e profileve të ndryshme, por gjithashtu i kemi të pranishme edhe rastet kur një pjesë të tyre u mungon ndjenja e përgjegjësisë, transparencës dhe llogaridhënies, veçanërisht kur bëhen pjesë e jetës publike, sidomos asaj politike. Andaj një prej roleve që duhet ta shprehin lëndët shoqërore, me theks të veçantë Sociologjia dhe Edukata qytetare, është ngritja e vetëdijes tek nxënësit se ndjenja e përgjegjësisë dhe llogaridhënies duhet t'i shoqërojë gjatë gjithë jetës, pavarësisht se në çfarë kohë, vende, situata dhe funksione të gjenden.

Nxënësit përgjithësisht mësojnë shumë apo mjaftueshëm në rrafshin teorik për natyrën, universin, sistemin diellor, shtazët, bimët, elektroteknikën, elektromagnetikën, ndërtimtarinë, arkitekturën, mekanikën dhe teknologjinë, por shumë pak mësojnë për vetë njeriun dhe shoqërinë, vlerat dhe solidaritetin, mirëqenien dhe humanizmin, dinjitetin dhe identitetin, tolerancën dhe transparencën, mirësjelljen dhe respektin, liritë dhe të drejtat e njeriut, kulturën dhe diversitetin, Zotin dhe religionin, ndërgjegjen dhe virtytin, përgjegjësinë dhe llogaridhënien, etikën publike dhe respektimin e ligjeve.

Prandaj, që temat, konceptet dhe drejtimet me profile natyrore e profesionale ta përmbushin kuptimin e tyre, duhet që te nxënësit të zhvillohet përgjegjësia ndaj vetvetes, shoqërisë, mjedisit dhe shtetit, të cilat përgjegjësi më së miri i përcjellin dhe i promovojnë tek nxënësit lëndët shoqërore, të tilla si Sociologjia, Edukata Qytetare, Psikologjia dhe Filozofia. Cilindo funksion, punë apo shërbim që ta kryejë, njeriut i nevojiten njohuritë, cilësitë dhe vlerat e mësipërme. Individit nuk është qenie mekanike që subjektivitetin e tij t'ia nënshtrojnë cilitdo profesion dhe veprimtari që i ofrohet dhe kështu të tjetërsohet gjatë atij procesi, duke e humbur kështu dinjitetin dhe identitetin e tij, por është qenie shoqërore dhe organike që veprimtarinë dhe

profesionin duhet t'ua nënshtrojnë nevojave të tij dhe shoqërisë në përgjithësi.

Megjithatë kjo asses, aspak dhe në asnjë mënyrë nuk nënkupton nënvlerësim të drejtimeve profesionale, të cilat përgatisin kandidatë potencialë për tregun e punës, përkundrazi drejtimeve të tilla duhet t'u garantohen kushte për manifestim praktik të teorisë, por edhe në të tilla profile lëndët shoqërore duhet ta kenë hisen e tyre, sepse në cilindo profesion të angazhohemi, do të kemi së paku një prej këtyre tre raporteve shoqërore: raporti nëpunës-drejtuës, nëpunës-nëpunës dhe nëpunës-klient. Sado që puna të jetë fizike dhe e natyrës krejtësisht praktike, raportet sociale gjithnjë i shoqërojnë individët, siç ka thënë filozofi antik Aristoteli: "Njeriu është pjesë e bashkësisë. Kush ndihet i pavarur prej saj është ose bishë ose perëndi".

Po ashtu, nuk mund të mohohet rëndësia cruciale që kanë matematika, teknologjia, bujqësia dhe në përgjithësi shkencat natyrore, por as të mohohet fakti se për shkencat shoqërore ende nuk është rezervuar vendi i merituar në arsimin parauniversitar, qëllimet e të cilit nuk mund të përmbushen plotësisht, veç të tjerash, pa e rritur edhe fondin e orëve të lëndëve shoqërore në të gjitha profilet e shkollave.

Ndërsa në gjimnazet gjuhësore-shoqërore mësohen të gjitha shkencat natyrore, në gjimnazet natyrore, e sidomos në drejtimet profesionale mësohen shumë pak lëndët shoqërore. Për rrjedhojë disa sjellje destruktive/devijante të një pjesë të nxënësve mund të manifestohen, veç të tjerash, edhe si pasojë e fondit të vogël të lëndëve shoqërore, të cilat do t'i adresonin dhe shtjellonin shumë shqetësime dhe dukuri negative me të cilat ballafaqohen adoleshentët, duke i vetëdijësuar për shkaqet, pasojat dhe mundësitë e zgjidhjeve të tyre.

Jemi dëshmitarë se dukuritë negative, si fyerjet, sharjet, dhuna psikike, emocionale dhe fizike, bullizmi, ngacmimet seksuale, plaçkitja, konsumimi i duhanit, pijeve alkoolike dhe lëndëve

narkotike dhe shumë dukuri me konotacione negative, kohët e fundit janë shpeshtuar tek një pjesë e nxënësve të shkollave të mesme të larta, por edhe tek klasat e nënta të shkollave të mesme të ulëta. Periudha e adoleshencës, e cila shoqërohet me ndryshime psiko-fizike, është një prej faktorëve që manifestohet me ndryshime në qëndrime dhe sjellje tek nxënësit, andaj duke qenë periudhë e ndjeshme dhe përcaktuese për të ardhmen e tyre, ndaj pjesëtarëve të kësaj grupmoshe duhet të jemi më të ndjeshëm dhe kujdesshëm, t'u qëndrojmë pranë, të konsultohemi, t'i pyesim se çfarë synojnë, t'i orientojmë drejt dijes dhe ambicieve të larta, drejt shkencës, aktiviteteve rekreative dhe sportive, mungesa e të cilave do të krijonte boshllëk tek ata, të cilin kërkojnë ta mbushin me diçka, thjesht që të mos ndihen 'zbrazët'.

Përveç këtyre çështjeve, edhe tekstet e lëndëve shoqërore kanë nevojë të rishikohen dhe plotësohen për t'u shtuar e trajtuar koncepte, tema dhe fenomene të aktualitetit me të cilat po përballen shoqëria në përgjithësi dhe rinia në veçanti. Ndërkohë që vetëm trajtimi i koncepteve, teorive dhe pikëpamjeve të teoricienëve, të shkëputura nga praktika, tek nxënësit nuk zgjon kërshëri të lartë nëse një pjesë e tyre nuk trajtohen nga perspektiva e aktualitetit dhe nuk ndërliiden me të.

Përfundimisht, shteti përmes institucioneve, institucionet përmes shkollave dhe universiteteve, shkollat dhe universitetet përmes lëndëve shoqërore duhet t'i ngrënë lart vlerat, pikëpamjet dhe qasjet si objektivizmi, paanshmëria, toleranca, diversiteti kulturor, drejtësia, barazia, përgjegjësia, llogaridhënia, mirësjellja, respekti, humanizmi, kritikizmi, paqja e solidariteti, të cilat duhet të manifestohen gjatë gjithë jetës, edhe atëherë kur përfundojnë shkolla, studimet universitare dhe post-universitare, sepse të tilla vlera asnjëherë nuk duhet ta humbasin rëndësinë e tyre tek njeriu, por gjithnjë ta shoqërojnë atë.



## India dhe SHBA-ja mbajnë manovra të përbashkëta ushtarake

NJU-DELHI, 6 SHTATOR - India dhe SHBA-ja do të zhvillojnë vitin e ardhshëm manovra ushtarake të përbashkëta në tokë, det dhe ajër, njoftoi të enjten për medie ministri indian i Mbrojtjes, Nirmala

Sitharaman. "Ne kemi vendosur të zhvillojmë për herë të parë në vitin 2019 manovra të përbashkëta (tokë, ajër, det) me SHBA-në në brigjet lindore të Indisë", deklaroi ministri.

Nirmala Sitharaman u shpreh në përfundim të takimeve me sekretarin amerikan të Shtetit, Mike Pompeo dhe sekretarin amerikan të Mbrojtjes, Jim Mattis. SHBA-ja po zhvillon përpjekje

të mëdha për të përforcuar lidhjet me Indinë. Uashingtoni është shumë i shqetësuar që të zhvillojë partneritete përbashkëta zhvillimit ushtarak dhe ekonomik të Kinës në rajon.



# Shtëpia e Bardhë në përpjekje për ta zbuluar autorin anonim

Presidenti Trump reagoi me tërbim të madh ndaj artikullit anonim të publikuar nga "New York Times" të mërkurën, i cili është shkruar nga një zyrtar aktual i administratës së tij dhe pretendonte se një koalicion i brendshëm në Shtëpinë e Bardhë po punonte për t'i penguar "prirjet e tij më negative" derisa ai të largohej, apo të rrëzohej nga Presidencia



UASHINGTON, 6 SHTATOR - Zëvendës-presidenti Mike Pence dhe sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, kanë mohuar njëzëri të kenë shkruar ndonjë "opinion" anonim shpërthyes, që tregonte se si një "rezistencë" e brendshme po punonte për të penguar pjesë të agjendës së presidentit Donald Trump, në një kohë kur Shtëpia e Bardhë po kërkon medoemos ta gjejë autorin.

Shefi i Shtëpisë së Bardhë u tall me artikullin duke thënë se "anonim do të thotë i paguximtë", ndërsa kritikoi ashpër "New York Times" që e publikoi atë, duke këmbëngulur se "ashtu sikurse ata nuk e duan Trumpin, edhe unë nuk i pëlqej ata sepse janë njerëz të pandershëm". "Nëse personi i paguximshëm anonim ekziston vërtet, NYT duhet për qëllime të

sigurisë kombëtare ta demaskojnë atë përbashkë Qeverisë, të paktën një herë të vetme", shkroi Trumpi në "Twitter" mbrëmjen e së mërkurës. Pompeo, i cili ndodhet për vizitë në Nju Delhi të Indisë, u tha reporterëve se ai artikull nuk ishte i tij, mes spekulimeve "të përgjakshme" që pushtuan Uashingtonin për gjetjen e autorit.

Sekretarja e Shtëpisë së Bardhë për Shtypin, Sarah Huckabee Sanders, e quajti "frikacak" atë që e ka shkruar opinionin, madje kërkoi që "gjëja më e drejtë që mund të bëjë ai apo ajo është të dorëhiqet". Pompeo tha se "nuk duhet të habitet askush" nga fakti që "NYT" zgjodhi ta botonte "një vepër të tillë" dhe se, nëse ai artikull ishte shkruar me të vërtetë nga një zyrtar i lartë

amerikan, media në fjalë nuk do t'ia hedhë pa lagur për "zgjedhjen e fjalëve të një aktori të pakënaqur, mashtrues dhe të keq". Pompeo vijoi më tej me akuzat ndaj medias se po përpiqet të minojë administratën "Trump" dhe e konsideron këtë gjë "ekstremisht shqetësuese". Në rrjetin social "Twitter", shumë vetë debatuan mbi

rëndësinë e përdorimit të fjalës "parim udhëheqës" nga autori anonim, që koincidon me fjalën e përdorur shpesh në fjalimet e tij nga zëvendës-presidenti Mike Pence. "Zëvendës-presidenti vendos gjithmonë emrin në opinionet e tij. NYT duhet të turpërohet, sikurse edhe personi i paguximtë që ka shkruar opinionin fals, të palogjikshëm dhe të pabazuar. Zyra jonë qën-

dron larg akteve të tilla amatore", njoftoi përmes një deklarate në "Twitter", zyra e zëvendës-presidentit Pence. Edhe drejtori i Inteligjencës Kombëtare (Shërbimit Informativ Kombëtar), Daniel Coats dha një deklaratë ku mohonte autorësinë, duke hedhur poshtë spekulimet se ai ose zëvendësi i tij mund të jetë autor i opinionit.

## Shekerinska: Të jemi partnere e besueshme e NATO-s



SHKUP, 6 SHTATOR - Ministri e Mbrojtjes, Shekerinska, ka falënderuar të gjitha 29 anëtarët e NATO-së për ndihmën e vazhdueshme ndaj Maqedonisë dhe apeloj që më 30 shtator edhe qytetarët ta japin kontributin e tyre, me qëllim që të finalizohet ky rrugëtim i gjatë.

"Ky është një partneritet mbi të cilën mund të mbështetemi, sepse kur na është dashur ndih-

më, NATO ishte këtu për të na ofruar atë. Tani edhe ne duhet të jemi partnerë mbi të cilën NATO do të mund të mbështetet. Më lejoni që të gjithë pjesëtarëve të ARM t'u ndaj një mirënjohje të madhe, sepse gjatë kësaj kohe vazhdimisht ka qenë lobuese e heshtur, por edhe një diplomat i dukshëm që Maqedonia të bëhet pjesë e NATO-s. Plot 4 000

pjesëtarë të ARM i kemi pasur në misione të NATO-së, kjo flet mjaftueshëm", theksoi ministrja e Punëve të Brendshme, Radmilla Shekerinska. Gjatë vizitës në kazermën në Ilinden, pjesëtarët e njësive për intervenime të shpejta kanë demonstruar ushtrime që kanë qenë pjesë edhe gjatë stërvitjeve të përbashkëta me vendet anëtare të NATO-s.

## IS-i merr përgjegjësinë për sulmet në Kabul

KABUL, 6 SHTATOR - Grupi militant Shteti Islamik (IS) e mori përgjegjësinë për sulmet e së mërkurës në Kabul, të cilat lanë të vrarë së paku 26 njerëz. Shteti Islamik, përmes agjencisë

së tij të lajmeve "Amaq", tha se bombarduesit kanë sulmuar "një tubim të të pafeve" në lagjen Dasht-e-Barçi të kryeqytetit afgan. Mbi 90 veta janë plagosur në

sulmet që goditën një klub të mundjes në lagjen e banuar me shumicë shiite. Një sulmues vetëvrasës e hodhi vetën në erë brenda klubit, ndërsa 40 minuta më vonë një

makinë bombë shpërtheu pranë. Që nga muaji janar në Kabul kanë ndodhur së paku 17 sulme që kanë lënë të vrarë së paku 430 njerëz.



**E jashtëzakonshme**

**U kap me kokainë brenda takave të larta, dënohet gruaja**

Një grua në ShBA është lënë në burg pasi u kap duke tentuar ta kontrabandonte kokainë. Denise Marie Woodrum u kap në aeroportin e Sidneit vitin e kaluar pasi zyrtarët e kufirit i

gjetën kokainë të fshehur brenda takave të larta dhe sende të tjera në bagazhin e saj. 51-vjeçarja ka pohuar se ishte mashtruar nga një person në internet. Të enjten



grykta e rrethit New South Wales ka dënuar Woodrum me 7 vjet burgim.

**BARSOLETA E DITËS**



- Ti djalë, a kurrë s'e ke ndërmend të mësosh a?
- Jo.
- E çfarë do t'u thuash prindërve për Vitin e Ri?
- Urime Viti i Ri!



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

**"INCREDIBLES 2" 3D**

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird



**FOTO E DITES**



Një pamje ajrore e kapur nga një helikopter tregon automjetet se si janë grumbulluar si shkak i erërave të forta në Kobe të Japonisë. /AFP/

Në ora 18:20

**"FUTURE WORLD"**

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco



Në ora 20:00

**"ANT-MAN AND THE WASP" 3D**

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed



Në ora 22:00

**"LOVING PABLO" (R)**

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 min

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

**E rrallë**

**T'i dhurosh të dashurës 1 250 trëndafila**

I riu i dhuroi të fejuarës 1 250 trëndafil të kuq. Një për çdo ditë të jetuar së bashku. Ky është gjesti i dashurisë i konceptuar nga Devid, drejtuesi i një bari kokteji, për të fejuarën e tij Raffaella. Siç raporton "Il Gazzettino", çifti nga Sabaudia e Italisë janë bashkë prej rreth katër vjetësh, por kohët e fundit ishin ndarë për shkak të një grindjeje. Tani që janë pajtuar, Devid donte ta habiste të fejuarën e tij, duke i



bërë një kompozim rekord nga luleshitësi i tij i besueshëm Angelo Pilati.



**DASHI**

Në ato situata që shikoni që s'mund të

bëni dot gjë, duhet të hapni rrugë. Ndonjëherë toleranca ndihmon më shumë se kokëfortësia.



**DEMI**

Humori juaj i keq sot mund të largojë

nga ju persona bezdisës, në të njëjtën kohë mund të prishë punë edhe me personat që ju duan.



**BINJAKËT**

Kjo është dita kur duhet të tregoheni

më të vendosur sa i përket një çështje profesionale. Nëse ndjeni nevojën të ndërhyini, bëjeni.



**GAFORRJA**

Nuk ju këshillohet ta sfidoni fatin sot

dhe as të shkoni kundër tij. Çdo gjë e menduar mirë do të japë rezultate të sigurta.



**LUANI**

Dita juaj nuk do të fillojë mirë sot.

Do të investohen shumë për të shpëtuar një marrëdhënie apo për të firmosur një kontratë, por nuk do t'ia arrini dot.



**VIRGJËRËSHA**

Keni pak vështirësi për t'i zgjidhur

pjesët e një çështje biznesi sot. Megjithatë, personat që keni marrë si bashkëpunëtorë do t'ju suportojnë.



**PESHORJA**

Sot jeni të shpërqendruar. Nëse jeni

në shoqërinë e të dashurve tuaj do të mendoni për punën dhe nëse jeni në punë, mendja ju rri veç të çështjet e zemrës.



**AKREPI**

Duhet të impenjoheni pak më shumë

për ta ndryshuar tërësisht statusin tuaj. I keni vënë qëllime vetes dhe do t'ia arrini patjetër.



**SHIGJETARI**

Për t'i zgjidhur çështjet private dhe

profesionale sot keni të gjithë ditën në dispozicion. Nëse nuk ju del koha, merrni më shumë hapësirë.



**BRICJAPI**

Nëse për ju miqësia

ka vlerë të konsiderueshme atëherë sot do të bëni një zgjedhje që do t'ju ofrojë miq të rinj në jetën tuaj.



**UJORI**

Nuk ka asgjë të keqe në atë që po

bëni për familjen tuaj, por të merrni në konsideratë këshillat e dhëna do të sjellë vetëm gjëra pozitive për ju.



**PESHQIT**

Jo çdo dëshirë e juaja është një

urdhër për të tjerët dhe sot do të ndiheni keq kur të kuptoni që dikush nuk e ka marrë në konsideratë këtë gjë.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

ITALY - POLAND

1

TOGO - BENIN

1

ROMANIA - MONTENEGRO

1

## Kosova dhe Shqipëria sonte debutojnë në Ligën e Kombeve

Sonte (e premte) shqiptarët do të kenë festë sportive, pasi luajnë Kosova dhe Shqipëria në Ligën e Kombeve. Të dyja këto skuadra synojnë ta nisin me fitore aventurën në këtë ligë, pasi synim kryesor mbetet kualifikimi në Kampionatin Evropian



të ishte një gjë e madhe dhe entuziazmi nuk na mungon", ka thënë Hysaj.

### Kosova U21 kërkon fitore ndaj Irlandës

Krahas Përfaqësueses A të Kosovës dhe Kombëtares së Shqipërisë, sonte (e premte) luan edhe Përfaqësuesja e Kosovës U21. Të rinjtë e Kosovës kundërshtar e kanë Irlandën, kurse ndeshja zhvillohet në stadiumin Olimpik "Adem Jashari" në Mitrovicë nga ora 19:00. Lidhur me këtë ndeshje, Ardian Ismajli ka deklaruar: "Prej se kanë filluar eliminatorët e këtij Evropiani atmosfera në ekip ka qenë jashtëzakonisht e mirë dhe kemi pasur një harmoni të madhe. Ky është edhe çelësi i suksesit tonë deri më tash. Vijnë në këtë takim pas rezultateve të mira në ndeshjet e fundit kundër Azerbajxhanit dhe Gjermanisë, prandaj besoj se edhe kundër Irlandës do të marrim rezultat pozitiv".

mirë, por ne do të përpiqemi ta japim maksimumin tonë të dijës dhe forcës që të dalim faqebardhë nga kjo ndeshje", ka thënë Ujkani, i cili bën me dije se fitoren e dëshirojnë për ish-presidentin e Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri.

Pas përfundimit të ndeshjes Azerbajxhan - Kosovë, Shqipëria në "Elbasan Arena" e pret Izraelin, një kundërshtar i njohur për shqiptarët, pasi në vitet e fundit janë përballur ndërmjet vete këto

dy kombëtare. Mbrojtësi Elseid Hysaj ka thënë se synimi i Shqipërisë është kualifikimi në Evropian, prandaj synohet fitore ndaj izraelitëve. "Nuk duhet t'i falim minuta Izraelit siç bëmë këtu në ndeshjen e parë. Kishim mundësi t'i fitonim të dyja ndeshjet. Ajo që duhet të bëjmë tani është përqendrimi. Kemi një trajner të ri dhe mendime të reja. E dimë ku duhet të përmirësohemi. Të gjithë duhet të kemi një gjë në kokë: kualifikimin në Evropian. Do

këndi dhe pika e bardhë. Kemi një kundërshtar mjaft të fortë e me agresivitet. Dua të kemi një ekip të mirë dhe nuk jam i fokusuar në individë. E di që të gjithë kanë dëshirë të luajnë, por ne duhet të dimë se kemi dy ndeshje dhe duhet të kemi lojtarë për dy ndeshje. Do të bëjmë atë që mundemi më së miri", ka thënë Challandes.

Në të njëjtën linjë me trajnerin e Kosovës është edhe kapiteni Samir Ujkani. Ky i fundit e vlerëson Azerbajxhanin si kundërshtar të papërshtatshëm, por beson në fitore. "Jemi përgatitur maksimalisht këto ditë, sepse nuk ka kundërshtarë të lehtë. Azerbajxhani ka një skuadër të

### Veton ZYMBERI

EPOKA E RE

**PRISHTINË, 6 SHTATOR** - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll nga ora 18:00 debuton në Ligën e Kombeve si mysafire e Azerbajxhanit, kurse dy orë e dyzetepesë minuta më vonë Kombëtarja e Shqipërisë do të luajë si vendëse kundër Izraelit. Trajneri i Kosovës, Bernard Challandes, ka thënë se kundërshtari ka një skuadër cilësore, por që Kosova synon të japë dhe marrë më të mirën në këtë ndeshje. "Unë dhe shtabi teknik kemi punuar mjaft këto ditë si në mbrojtje, mesfushë dhe sulm. Kemi ushtruar lojën presing, gjuajtjet e lira, nga

## Përurohët Qendra Rinore në Pejë

**PEJË, 6 SHTATOR** - Qyteti më perëndimor i Kosovës, Peja, sot u bë me Qendrën e Rinisë. Të rinjtë e kësaj treve tani e tutje do ta kenë shtëpinë e vet të re. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, bashkë me kryetarin e kësaj komune, Gazmend Muhaxheri, zyrtarë të Ministrisë e Komunës dhe përfaqësues të strukturave rinore, bënë përuroren e këtij objekti, investim i tërësisht i MKRS-së, në vlerë prej 220 mijë eurosh. Projekti deri në finalizimin e tij ka zgatur dy vjet. Në takimin që zhvilluan ministri Gashi dhe kryetari Muhaxheri, e vlerësuan se ky projekt kapital është i rëndësishëm për të rinjtë pejanë dhe tani ata kanë hapësirën e mjaftueshme dhe moderne se ku t'i realizojnë aktivitetet dhe grumbullimet e tyre. Po ashtu, Gashi e Muhaxheri

kanë biseduar edhe për projekte dhe mundësi të tjera të bashkëpunimit e bashkëinvestimit në të mirë të qytetarëve të Komunës së Pejës. Konkretisht, diskutuan edhe për zgjidhjen e çështjes së Qendrës Nacionale të Xhudos, e cila shumë shpejt do të fillojë të ndërtohet.

Ministri Gashi, ka shprehur kënaqësinë për realizimin e këtij projekti, duke e konsideruar se të rinjtë e Pejës tani kanë vendin e tyre, adresën ku mund të takohen, planifikojnë dhe jetësojnë aktivitetet në interesin e tyre. Ministri Gashi çmoi punën që është bërë dhe porositi që objekti të ruhet e të menaxhohet sa më mirë ashtu që të përcillet te gjener-



atat që do të vijnë pas. Ministri Gashi premtoi se ministria që ai udhëheq mbetet maksimalisht e interesuar dhe e angazhuar që të punojë në mbështetje të të rinjve dhe interesave të tyre, përmes edukimit joformal dhe fuqizimit të tyre duke i nxitur për angazhim më të madh në vendimmarrje.

"Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka qenë investuese e këtij projekti dhe jemi duke planifikuar edhe disa investime në komuna të tjera. E kemi përfunduar projektin në Vushtrri, jemi duke investuar në Komunën e Ferizajt dhe shumë shpejt do të fillojmë me tri qendra të tjera rinore në qytete të ndryshme, në mënyrë që të rinjve të Kosovës t'u krijohen mundësi dhe hapësira të reja në shërbim të aktivitetëve rinore sepse, siç dihet, pjesa më vitale e shoqërisë janë të rinjtë", ka thënë ministri Gashi. "Ne si ministri e kemi në plan të veçantë investimin në fushat e rinisë, edhe te pjesa e investimeve kapitale, infrastrukurore dhe

pjesa e programeve rinore. Besoj se kështu fuqishëm do të vazhdojmë edhe gjatë vitit 2019", ka deklaruar ministri Gashi. Ndërsa kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, falënderoi ministrin Gashi për mbështetjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm që MKRS-ja ka me komunën në projekte që janë në interes të komunës. Ai e vlerësoi se ky projekt do të krijojë kushte më të mira për të rinjtë e Pejës. "Është një qendër rinore e cila është e punuar mjaft mirë. Besoj se do t'i shërbejë edhe lagjes Dardania, por edhe të gjithë komunitetit rinor që merret me aktivitetet sportive", ka thënë kryetari Muhaxheri. Ministri Gashi dhe kryetari Muhaxheri vizituan edhe stadiumin "Shahin Haxhiislami" për t'i parë nga afër punimet që po zhvillohen në këtë stadium.

## Bushi: Pranim një transferim më të madh nga Grezda

**TIRANË, 6 SHTATOR** - Trajneri i Kombëtares së Shqipërisë U21, Alban Bushi, në një intervistë për medien skoceze "The Scottish Sun" ka thënë se Eros Grezda ka merituar një transferim në një klub më të madh se Rangersi. "Kur e shikon sa i talentuar është

Grezda, ne të gjithë prisnim një lëvizje më të madhe të tij se tek Rangersi. Ai është një lojtar që mund të jetë pa frikë i një klase botërore. Por, jam i sigurt se shpejt do të përshtatet te Rangersi, duke ditur kualitetet e tij. Do lërë një gjurmë të madhe aty. E meritonte një

transferim më të madh. Mendoj se do të bëjë mirë në Skoci. Është një lojtar shumë i rëndësishëm për Shqipërinë. Dhe kur ai luan mirë, i gjithë ekipi është në formë të mirë. Erosi ka punuar shumë fort. I uroj fat të mbarë!", ka thënë Bushi.



## Sermaxhaj, trajner i Ballkanit

**SUHAREKË, 6 SHTATOR** - Sami Sermaxhaj është trajner i ri i skuadrës së Ballkanit. Ai në pozitën e trajnerit e zëvendëson Bekim Shotanin, i cili dha dorëheqje pas humbjes nga

Feronikeli (1-0). "Pas një pushimi pesëditor pa trajner, nga sot rrugëtimin tonë iu bashkëngjitet trajneri i mirënjohur Sami Sermaxhaj. FC Ballkani është shumë mirënjohës klubit më të madh në vend - FC Prishtinës - për lejimin e trajnerit që t'i bashkëngjitet rrugëtimin tonë. Klubit i duhet mbështetje sa më e madhe në qytetin tonë,

që ta marrim rrugën e duhur dhe të fitores për një përfaqësim sa më të mirë në IPKO Superligën e Kosovës", thuhet në njoftimin e skuadrës së Ballkanit.



## 'Arusha' pensionohet nga futboli

Premton Muja, i njohur me nofken "Arusha", është pensionuar nga futboli aktiv. Ai ka qenë pjesë e Përfaqësueses së Kosovës, kurse me sukses të plotë ka luajtur për shumë klube në vend, derisa karrierë ka bërë edhe në Shqipëri dhe Çeki. Në karrierën futbollistike ka luajtur mbi 500 ndeshje zyrtare, derisa ka shënuar 103 gola

EPOKA  
ERE

Liridon ZEQRIRI

**GJILAN, 6 SHTATOR** - Sulmuesi i njohur nga Gjilani, Premton Muja, ka njoftuar edhe zyrtarisht se është pensionuar nga loja e futbollit, pas një karriere të suksesshme 25-vjeçare. "Pas shumë viteve si futbollist aktiv, më shumë se 25 vjet karrierë sportive kam marrë një vendim jo të lehtë për mua. Që nga ky moment tërhiqem nga futboli i luajtur. Çdo fillim e paska edhe një fund. Ishte futboli që më ofroi shumë gjëra gjatë këtyre viteve. E paskam problem ta pranoj këtë realitet, por ja që kjo qenka një tjetër sfidë për mua që duhet të kalojë, pasi me radhë janë sfidat e tjera", ka thënë Muja, i cili ndihet i lumtur që futboli e drejtoi në rrugën e duhur, duke i mësuar respektin, edukatën dhe kulturën.

Sulmuesi që pjesën më të madhe e kaloi në Gjilan, ka thënë se sukseset e ekipit gjithmonë ishin primare për të, kurse më pas falënderoi të gjithë ata që e ndihmuan në karrierën e tij. "Faleminderit familjes në rend të parë për përkrahjen gjatë gjithë këtyre viteve, prindit tim Selim Muja, i cili ishte edhe trajneri im i parë në lojën e futbollit. Faleminderit të gjithë shokëve të fëmijërisë, duke nisur nga moshatarët e parë që kisha në kategoritë e reja. Faleminderit të gjithë bashkëlojtarëve të mi që kemi luajtur bashkë për këto vite dhe emocionet që i kemi ndarë së bashku! Faleminderit trajnerëve kosovarë që kemi punuar së bashku, e që gjatë karrierës sime sportive kisha mbi 50 të tillë! Faleminderit të gjitha klubeve dhe drejtuesve të tyre ku kam djersitur fanellën e tyre me plot krenari dhe sukseset i kemi ndarë së bashku! Faleminderit



edhe komunitetit të gazetarëve, pasi pa ndihmën e tyre nuk do të isha ky që jam sot! Një falënderim shumë të madh edhe për gjithë publikun e Kosovës që gjatë këtyre viteve më dha shumë emocione dhe më qëndroi pranë si në momentet e mira, po ashtu edhe në të vështira", ka thënë Muja, i cili ka falënderuar edhe Federatën e Futbollit dhe tifozët e të gjitha skuadrave ku ka luajtur. Në fund Muja ka treguar se e ardhmja e tij sërish do të jetë e lidhur me

lojën e futbollit. "Futbollin nuk po e braktisi që nuk po mundem, por është një moment që duhet të mendoj edhe për të ardhmen, e cila është e drejtuar nga fëmijët dhe gjeneratat e reja, pasi që punën time do ta vazhdoj si pedagog sportiv dhe trajner futbollit", ka deklaruar ai. Muja në karrierë ka luajtur për këto klube: Gjilanin, Drenicën, Elbasani, Fushë-Kosovën, Besën e Pejës, KEK-un, Vllaznia Pozharanin, Kikën dhe Hlucin në Çeki.

## Pogba: Jam lojtar i Unitedit, të ardhmes nuk i dihet

Mesfushori Paul Pogba ka thënë se nuk është i sigurt se çfarë do të ndodhë në të ardhmen, por ka thënë se tani për tani është në Manchester United. "Për momentin e ardhmja ime është në Mançester sepse kam ende kontratë me ta. Jam duke luajtur aty për momentin, por askush nuk

e di se çfarë do të ndodhë gjatë muajve të ardhshëm", ka thënë Pogba për "Sky Sports Germany". Megjithatë, mesfushori francez ka insistuar se ai dhe Mourinho kanë një marrëdhënie plotësisht profesionale dhe se ai është duke dhënë maksimumin e tij për çdo ndeshje, pavarësisht se kush është

trajner. "Ne kemi një marrëdhënie profesionale, siç duhet ta ketë një trajner dhe një lojtar. Mund t'ju siguroj për një gjë, unë gjithmonë do të jap më të mirën time, pavarësisht se kush është trajner, jap gjithçka për Unitedin. Nuk mund të them më shumë", ka shtuar Pogba.

### SHKURT

#### Marcelo refuzon Juventusin

Mbrojtësi i Real Madridit, Marcelo, e ka përjashtuar mundësinë e transferimit në Juventus. Brazili ka bërë me dije se dëshira e tij është që karrierën ta mbyllë në Real. "Dua ta mbyll karrierën te Reali i Madridit. Qarkullojnë shumë opinione, që përfundojnë si lajme, por që në fund të fundit janë vetëm sajesa. Kam entuziazmin e 18-vjeçarit Vinicius. Çdo vit e kam treguar dëshirën time për të kontribuar për Realin. Ka shumë njerëz që fshihen pas rrjeteve sociale dhe shpikën gjëra të pakuptimta. Kam ende shumë vite kontratë me Realin dhe jam shumë i lumtur këtu në Madrid", ka thënë Marcelo, i cili ka kontratë me Realin deri në vitin 2022.

#### Lopetegui: Modriqi e fiton 'Topin e Artë'

Trajneri i Real Madridit, Julen Lopetegui, është i bindur se Luka Modriqi do ta fitojë "Topin e Artë" dhe jo Cristiano Ronaldo. "Modriqi do të fitojë 'Topin e Artë', pasi është lojtari më i mirë në botë", ka thënë Lopetegui.

#### Ferrari zgjedh Leclerc në vend të Raikkonenit


Duket se gjithçka u përfol në Monza pritet të bëhet realitet. Ferrari do të largojë Kimi Raikkonenin. Sipas së përditshmes italiane "La Gazzetta dello Sport", drejtuesit e "kokëkuqes" italiane ia komunikuan finlandezit vendimin e tyre pikërisht përpara Çmimit të Madh të Italisë, gjë që shpjegon edhe sjelljen e Raikkonenit në pistë, pasi nuk e ndihmoi shumë Sebastian Vettelin gjatë garës. Gjithnjë sipas "La Gazzetta dello Sport", Ferrari ka vendosur ta zëvendësojë Raikkonenin me të riun Charles Leclerc, pilot i formuar në Akademinë e skuadrës italiane që garon me Sauber Alfa Romeo, i cili ka nënshkruar një kontratë dyvjeçare. Ai që mungon në këtë histori është vetëm zyrtarizimi i këtij lajmi. Në fakt, zërat për largimin e Kimi Raikkonenit nga Ferrari, për t'u zëvendësuar nga Leclerc, po qarkullojnë prej kohësh. Për pilotin 20-vjeçar nga Monako, që u kërkua me forcë edhe nga Sergio Marchionne, i ndarë nga jeta pak kohë më parë, kalimi te Ferrari është një hap i madh në karrierë. Ndërsa për Raikkonenin paraqitet e mira në garat e fundit të Formulës 1 nuk i shërbyen për ta siguruar qëndrimin te skuadra italiane edhe sezonin e ardhshëm.

#### Mbappe dënohet tri ndeshje

Kylian Mbappe e paguan shtrenjtë ndëshkimin e tij me karton të kuq në takimin me Nimesin. Sulmuesi i PSG-së reagoi ashpër ndaj ndërhyrjes me qëllim të Teji Savenier, duke e shtyrë kundërshtarin, i cili u rrëzua në tokë. Komisioni i Disiplinës në Federatën Franceze të Futbollit vendosi ta pezullojë tri ndeshje 19-vjeçarin, ndërsa Savinierin pesë ndeshje. "Ylli" parizien do të mungojë ndaj Sant Ettienet më 14 shtator, si dhe në sfidën me Rennesin më 23 shtator dhe me Reimsin më 26 shtator.

#### Varane: Nuk më intereson 'Topi i Artë'

Qendërmbrojtësi i Real Madridit, Raphael Varane, ka insistuar se atij nuk i intereson se kush do ta marrë çmimin "Topi i Artë". "Është një shpërblim individual. Ne po luajmë në një sport kolektiv. Ky çmim tregon për punën që ke bërë gjatë një sezoni, por është çmim personal. Nuk është synimi ynë dhe edhe nëse nuk e fitoj, nuk do të jetë një zhgënjim për mua. Është e vërtetë që sezonin e kaluar ka qenë i mrekullueshëm për mua. Do të jetë e vështirë që të arrij më shumë këtë sezon, përveçse nëse arrij t'i shënoj 40 gola", ka thënë Varane.



Në bazë të nenit 66.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr.03/L-40, neni 6 të Statutit të Komunës, Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr.08/2014 të datës 25.02.2014, vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikqyrës Për Shërbimin Civil të Kosovës me numrat rendor.180/2018,181/2018,187/2018,196/2018 dhe 197/2018 të nxjerrura me datë,10.08.2018 Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec ri shpall:

### KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës në SHFMU-të dhe SHML-të e komunës së Rahovecit

- 1) Një drejtor për SHFMU "Tre Dëshmorët" në Vrajakë
- 2) Një drejtor në SHFMU "Bajram Curri" në Krushë të Madhe
- 3) Një drejtor në SHFMU "Mustafë Ibishi" në Kramovik
- 4) Një drejtor në SHFMU "Heronjtë e Kosovës" në Hoçë të Vogël
- 5) Një drejtor në SHFMU "Sylejman Vokshi" në Polluzhë
- 6) Një drejtor në SHFMU "Skënder Kastrati" në Malësi të Vogël
- 7) Një drejtor në SHML "12 Maji" në Ratkoc

Kushtet për konkurim:

1. Të gjithë kandidatët e interesuar për konkurim në vendet e punës për drejtor shkolle duhet t'i plotësojnë këto kushte:
  - 1.1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës
  - 1.2. Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas Udhëzimit për licencimin e mësimdhënëseve dhe Normativit mbi punësimin e kuadrit të mësimdhënëseve dhe rregullativës tjetër ligjore.
  - 1.3. Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedurë të licencimit.
2. Të kenë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim e menaxhim.
3. Të kenë së paku 3 vite përvojë pune në arsim ose në institucione arsimore.
4. Kandidatët konkurent duhet të posedojnë këto dokumente:
  - 4.1. Ekstraktin e lindjes
  - 4.2. Diploma e fakultetit të kryer për nivelin përkatës
  - 4.3. Dëshminë për përvojën e punës
  - 4.4. Portfolion profesional (shihni shtojcën "G" të U A 08/2014)
  - 4.5. Letër referencë nga një institucion publik kredibil (si MASHT-i, DKA, Këshilli drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë)
  - 4.6. Letër referencë, e cila duhet të ketë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake.
  - 4.7. Planin zhvillimor të institucionit edukativo arsimor dhe aftësues për të cilin ka konkuruar (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12)
  - 4.8. Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor.
  - 4.9. Dëshminë që dëshmon që kandidati/ia nuk është nën hetime.

Detyrat e punës:

Detyrat e punës së drejtorit të shkollës janë të përcaktuara në rregulloret për organizimin e punës dhe të mësimin në shkollë.

Kohëzgjatja: Marrëdhënia e punës lidhet përmes kontratës, në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligjin për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës dhe zgjat 4 (katër) vite, duke e përfshirë edhe periudhën tremujore provuese.

Aplikacionet për konkurim merren në DKA dhe dokumentet dorëzohen po aty.


Afati i konkurimit është 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit.

RAHOVEC  
05.09.2018



Avni Morina, Drejtor

*Avni Morina*



## OFERTË PËR SHITJE TË SHTËPISË

Shitet shtëpia dykatëshe, me sipërfaqe prej 218 m<sup>2</sup>, dhe trualli me sipërfaqe prej 410 m<sup>2</sup>.

Shtëpia gjendet në Prishtinë, në lagjen "Aktash I", rr. "Ferhat Draga" nr. 1.

Procedura e transaksionit nga shitësi te blerësi bëhet pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes dhe pagesës së çmimit të kontraktuar, pastaj paluejtshmëria e përshkruar më lart kalon te blerësi.

Çmimi sipas marrëveshjes.

**Informata më të hollësishme mund të merren në numrin e telefonit 001-347-331-8305 në Nju Jork, kurse në Prishtinë në celularin 044-166-580.**

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi





Nr. Prot: 2089/18; Datë: 06.09.2018

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës numër 03/L-212, nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë si dhe dispozitat e nenit 48 pika 1.3. të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Senati i UShAF-it, në përputhje me Statutin dhe Rregulloren në fuqi për të ardhurat personale, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.07.2018 vendosi që të shpallë:

## KONKURS

**Për angazhim me honorar të personelit akademik në bazë të nevojave akademike të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj për vitin akademik 2018/19.**

Angazhimi me honorar i personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit, Rregullores për të ardhurat personale të UShAF, dhe Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës, nr.03-L-212 për lëndët:

- Tre (3) lektor për lëndën: Gjuhë Angleze;
- Një (1) lektor për lëndën: Gjuhë Gjermane;
- Një (1) ligjërues për lëndën: Hyrje në Turizëm;
- Një (1) ligjërues për lëndën: Zhvillimi i Produktit në Turizëm dhe Hoteleri;
- Një (1) ligjërues për lëndën: Sjellja e Konsumatorit;
- Një (1) ligjërues për lëndën: Shkathësi Informatike;
- Një (1) ligjërues për lëndën: Menaxhimi i Operacioneve Shërbyese;
- Një (1) ligjërues për lëndën: Menaxhimi i Cilësisë;
- Një (1) ligjërues për lëndën: Ruajtja e Ambientit dhe Turizmi;
- Një (1) ligjërues për lëndën: Menaxhimi i Pijëve dhe Ushqimit;
- Një (1) ligjërues për lëndën: Teknika e Matjes;
- Një (1) ligjërues për lëndën: Termodinamika;
- Një (1) ligjërues për lëndën: Sistemet Hidraulike dhe Pneumatike;
- Një (1) ligjërues për lëndën: Projektimi i Linjave të Prodhimit;
- Një (1) ligjërues për lëndën: Projektimi i Proceseve Teknologjike;
- Një (1) ligjërues për lëndën: Menaxhimi i TI - së;
- Një (1) ligjërues për lëndën: Sociologji Ekonomike;
- Një (1) ligjërues për lëndën: Fizika;
- Një (1) ligjërues për lëndën: Vizatim Teknik me Gjeometri Deskriptive;
- Një (1) ligjërues për lëndën: CAD/CAM;
- Një (1) ligjërues për lëndën: Analiza e Elementeve të Fundme;
- Një (1) ligjërues për lëndën: Programimi i Orientuar në Objekte;
- Një (1) ligjërues për lëndët: Detalet e Makinave I dhe Detalet e Makinave II;
- Një (1) ligjërues për lëndën: Bazat e Makinerisë;
- Një (1) ligjërues për lëndën: Burimet Energjive të Ripërtëritshme, Eficienca dhe Liberalizimi i Tregut të Energjisë;
- Një (1) ligjërues për lëndën: Bazat e Mekanikës.

### I. Kushtet e përgjithshme për angazhim:

1. Personeli i jashtëm akademik mund të angazhohet në UShAF për një periudhë të caktuar kohore, me qëllim të realizimit të veprimtarisë arsimore, shkencore dhe artistike, mbi bazën e konkursit publik, për pagesë me honorar, si bashkëpunëtor i jashtëm. Angazhimi sipas këtij konkursi nuk nënkupton themelimin e marrëdhënies së rregullt të punës e as pagesë me automatizëm gjatë periudhës për të cilën angazhohet.
2. UShAF-i gjatë përzgjedhjes së stafit për angazhim në mësimdhënie (ligjërata), përparësi do t'iu jepet kandidatëve që më parë kanë pasur një thirrje akademike ose ishin të angazhuar më parë në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj dhe Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, e të cilët kanë pasur performancë të kënaqshme në procesin mësimor.
3. Në UShAF, nuk do të lejohet rekrutimi/angazhimi i kandidatëve të cilët brenda një Fakulteti apo programi përkatës kanë në marrëdhënie pune familjar të ngushtë.

### II. Kohëzgjatja e kontratës për honorar dhe kompensimi

1. Kandidatët të cilët do të përzgjedhen për angazhim me honorar në mësimdhënie do të pajisen me kontrata për honorar varësisht prej fondit të orëve që posedojnë.
2. Nënshkrimi i kontratave për angazhim me honorar do të bëhet vetëm pas konstatimit të normës së orëve dhe grupeve që do të formohen pas pranimit të studentëve. Kontratat do të bëhen veç e veç për secilin semestër të vitit akademik 2018/2019.
3. Kompensimi do të bëhet në përputhje me raportin e orëve të realizuara gjatë semestrit të caktuar i cili vërtetohet nga njësi përkatëse akademike, por jo më shumë se fondi i orëve të përcaktuara sipas Rregullores në fuqi për të ardhurat personale të personelit akademik të UShAF-it.
4. Të gjitha kontratat e përkohshme të angazhimit me honorar do të jenë të bazuara në dispozitat e Statutit, Rregullores për të ardhurat personale të personelit akademik të UShAF-it dhe në bazë të Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës nr. 03-L-212 përkatësisht dispozitave të nenit 8; nenit 10, paragrafi 2, pika 2.2, si dhe paragrafit 4, 7 dhe 8; nenit 11 dhe nenit 14 të këtij Ligji.

### III. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

1. Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente:
  - a) Kërkesën me biografi,
  - b) Certifikatën e lindjes,
  - c) Diplomën origjinale ose kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar nga organi kompetent (kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë vendit duhet të sjellin vendimin për nostrifikim- barasvlerën e diplomës përkatëse bachelor, master, magjistraturë.
  - d) Dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale, si dhe informatat e tjera specifike shtesë.
  - e) Dëshmitë për angazhim paraprak në ndonjërin prej Universiteteve publike ose në ndonjë institucion të akredituar të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës (IAL).
  - f) Dëshmia për njohjen e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparsi për konkuresit.
  - g) Deklaratën për punësim (për punësim primar, sekondar)

### IV. E drejta e ankesës ndaj vendimit të Senatit:

1. Ndaj vendimit të Senatit mund të bëhet ankesë në komisionin e Senatit për ankesa dhe parashtesa në kuadër të Universitetit.
2. Ankesa do të bëhet më së largu 7 ditë nga dita e shpalljes së rezultateve të Senatit të UShAF-it me të cilin pala konsideron se i është mohuar e drejta për angazhim.
3. Ankesa duhet të dorëzohet në UShAF-it, ndërsa do të shqyrtohet brenda 15 ditëve të punës nga Komisioni i Senatit për Ankesa dhe Parashtesa.
4. Raporti i ankesave të shqyrtuara nga Komisioni i Ankesave dhe Parashtesave do të propozohet për rishqyrtim dhe vendosje përfundimtare në nivel të Senatit të UShAF-it.
5. Pala ankuese do të njoftohet me shkrim lidhur me vendimin e Senatit, si shkallë e fundit për çështje akademike në nivel të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.
6. Kundër vendimit përfundimtar të Senatit, kandidati mund të parashtroj ankesë në organet kompetente.

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në kopje të fortë në UShAF dhe të skanuara në adresën elektronike [info@ushaf.net](mailto:info@ushaf.net) Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara, si dhe ato që nuk deponohen të skanuara përmes postës elektronike në adresën e lartëcekur, nuk do të merren në shqyrtim. Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor, nga data 07/09/2018 deri më datë 21/09/2018.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- |  |   |
|--|---|
| <ul style="list-style-type: none"> <li>▶ D.P.Z. "Dilhan" shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr 70716291</li> <li>▶ D.P.Z "Dini" shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70350035 dhe nr. fiskal 600122501.</li> <li>▶ Fatmir Sfishta, shpallë të pavlefshme diplomën master të lëshuar në U.P. "Hasan Prishtina", në vitin 2013.</li> <li>▶ Bengi Sinik shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren.</li> <li>▶ Leonora Gojani shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMM "Luciano Motroni" Prizren.</li> <li>▶ Muhamed Mazllami shpall tr pavlefshme dëftesat dhe diplomën Medreseja Alaudin Prizren.</li> <li>▶ Altin Thaqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I-IX shf "Zef Lush Marku" Velezh.</li> <li>▶ Ermal Sopjani, nga Prishtina, shpallë të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Nazim Gafurri" Prishtinë.</li> <li>▶ Edona Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmm "Luciano Motroni" Prizren.</li> <li>▶ Ajhan Zeneli shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmm "Luciano Motroni" Prizren.</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Ferit Dervishi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.</li> <li>▶ Dzeneta Bajrami shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.</li> <li>▶ Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.</li> <li>▶ Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift në Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155</li> <li>▶ Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.</li> <li>▶ Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtinë, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155</li> <li>▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.</li> </ul> |
|--|---|

**Lëshoj shtëpinë me qira, e cila gjendet në lagjen e "Universiteti" përball rrugës B dhe përball marketit Viva Fresh Store. Shtëpia është 100 metra katror dhe e mobiluar. Është e përshtatshme për zyre dhe banim. Numri kontaktues 049-574-169.**

## INFORMATA PËR APLIKUESIT

Komiteti i ekspertëve për përzgjedhjen dhe përdorimin e barnave esenciale

Takimi i Komitetit të Ekspertëve për përzgjedhjen dhe përdorimin e barnave esenciale për të rishikuar dhe përditësuar Listën Nacionale të Barnave Esenciale (EML) do të zhvillohet në Prishtinë, gjatë muajve Gusht – Dhjetor 2018.

Aplikimet për përfshirjen e barnave të reja dhe ndryshimet ose fshirjen e barnave aktualisht të listuara, në Modelin e listës të 2018 duhet të dërgohen me e-mail në Sekretariatit e Listës së Barnave Esenciale të MSH në e-mail: [msh.info@rks-gov.net](mailto:msh.info@rks-gov.net) si dhe në Sekretarinë e komisionit përmes protokollit të MSH në kopje fizike në formatet PDF dhe Word ndërmjet 15 Gusht dhe 15 Tetor 2018.

Periudha e aplikimit është zgjeruar për të lehtësuar bashkëveprimin ndërmjet aplikantëve dhe Sekretariatit, për të siguruar që aplikacionet adresojnë në mënyrë adekuate elementet kritike për përzgjedhjen: rëndësinë e shëndetit publik, efikasitetin klinik dhe sigurinë e barit të propozuar. Kërkesat e plota për informacionin që duhet të përfshihen në një aplikim janë përkrahur me poshtë. Përvçë kësaj, çdo aplikim duhet të shoqërohet me një formular të kompletuar të Përmbledhjes së Informacionit të Aplikacionit.

Ju lutem, vini re se Sekretariatit mund të mos i pranojë aplikacionet nëse nuk i plotësojnë kërkesat e nevojshme për përmbajtjen dhe cilësinë.

Të gjitha aplikacionet do të postohen në faqen e internetit të MSH për koment dhe shqyrtim publik.

Ju lutemi drejtoni çdo kërkesë në:

Për Sekretarinë - Sekretariatit i Listës së Barnave Esenciale

Ministria e Shëndetësisë

Rr. Zagrebi nr. 60

10000, Prishtinë -Kosovë

e-mail: [msh.info@rks-gov.net](mailto:msh.info@rks-gov.net)

Informacion për t'u përfshirë në aplikacionin për përfshirje, ndryshim ose fshirje të një bari në Listën Nacionale të Barnave Esenciale të MSH

### Produktet e Përgjithshme

#### 1. Deklaratë përmbledhëse e propozimit për përfshirje, ndryshim ose fshirje.

Për përfshirjen e barnave të reja ose ndryshimet në listimin e barnave ekzistuese: përshkruani shkurtimisht propozimin në terma të indikacioneve klinike, popullatës së synuar dhe rolin në terapi për barin e kërkuar (1-2 paragrafë).

SHËNIM: Kur një bar është i rëndësishëm për trajtimin e fëmijëve, aplikacioni duhet të përmbajë një propozim për të shuar barin në EMLc dhe duhet të përfshijë të dhënat pediatrike në dispozicion.

Për fshirjen e barnave ekzistuese të listuara, ndryshimit në forcën e barit dhe/ose formulimet: përshkruani shkurtimisht propozimin, duke dhënë arsyetime të qarta dhe arsytim për fshirjen e propozuar. Identifikoni trajtimet alternative në dispozicion dhe çdo pasojë të parashikueshme të fshirjes.

#### 2. Emri i departamentit teknik të MSH-së/SHSKUK dhe pikën fokale që mbështet aplikacionin (aty ku është relevante).

Specifikoni departamentin teknik të MSH/SHSKUK që mbështet aplikacionin (nëse është e aplikueshme). Rekomandohet që aplikantët të angazhohen dhe të kërkojnë mbështetje nga departamenti teknik i MSH/SHSKUK-së.

#### 3. Emri i organizatës konsultuese dhe/ose që mbështet aplikacionin.

Specifikoni nëse organizatat e tjera janë konsultuar në lidhje me aplikimin dhe/ose mbështetjen aplikacionin. Ju lutemi specifikoni lidhjen e aplikantit me organizatën.

#### 4. Emri i pambrojtur ndërkombëtar (INN) dhe kodi anatomik terapeutik kimik (ATC) i barit.

Barnat duhet të përshkruhen - propozohen sipas emrit INN (ose emrit gjenerik). INN-të lehtësojnë identifikimin e substancave farmaceutike ose substancës aktive farmaceutike. Çdo INN është një emër unik që është i njohur globalisht.

Përfshini kodin ATC për barin për indikacionin përkatës. Sistemi ATC klasifikon barnat sipas organit ose sistemit anatomik mbi të cilin ato veprojnë dhe nga nëngrupet terapeutike, farmakologjike dhe kimike. Një bar i vetëm mund të ketë më shumë se një kod ATC, në varësi të indikacioneve për përdorim. Një version lehtë i qasshëm i indeksit të plotë të ATC është në dispozicion në: [http://www.whooc.no/atc\\_ddd\\_index/](http://www.whooc.no/atc_ddd_index/).

#### 5. Formulimi (et) dhe forca (t) e propozuara për përfshirje në listë; përfshirë të rriturit dhe fëmijët (nëse është e përshtatshme).

Aplikacioni duhet të identifikojë formulimet specifike dhe forcën e barit për të cilat kërkohet përfshirja në EML. Terminologjia e përdorur për format e dozimit në LBE mund të gjendet në Regjistrin e Barnave ose ajo e OBSH në Raportin e Komitetit Ekspertëve të OBSH-së për Përzgjedhjen dhe Përdorimin e Barnave Esenciale (Aneksi 1, Tabela 1.2), në dispozicion në: [http://apps.who.int/iris/bitstream/10665/189763/1/9789241209946\\_eng.pdf?ua=1](http://apps.who.int/iris/bitstream/10665/189763/1/9789241209946_eng.pdf?ua=1).

#### Detajet e disponueshmërisë aktuale të tregut të formulimit dhe forcës(ave) të propozuara duhet të përfshihen gjithashtu.

#### 6. A kërkohet përfshirja në listë si bar individual apo si përfaqësues i një klase farmakologjike?

Aplikimi duhet të specifikojë nëse kërkesa për përfshirje është për një bar individual, ose një bar me një simbol kuti katror, që përfaqëson një klasë farmakologjike.

Një simbol kuti katror (□) përdoret për të treguar se ka një numër të agjentëve brenda një klase farmakologjike me performancë të ngjashme klinike. Bari i listuar duhet të jetë shembulli i klasës për të cilën ekziston dëshmi më e mirë për efektivitetin dhe sigurinë. Kur nuk ka dallim në lidhje me të dhënat e efikasitetit dhe sigurisë, bari i listuar duhet të jetë ai që zakonisht është në dispozicion me çmimin më të ulët, bazuar në burimet ndërkombëtare të informacionit të çmimit të barnave.

Nëse kërkohet një listë kutish katrorë për barin, aplikacioni duhet të identifikojë alternativat që mund të konsiderohen si të krahasueshme në aspektin e efektivitetit dhe sigurisë.

## Detajet e trajtimit, rëndësia e shëndetit publik dhe vlerësimi dhe sinteza e provave

### 7. Detajet e trajtimit (kërkesat për diagnozën, trajtimin dhe monitorimin).

Aplikimi duhet të specifikojë regjimin e propozuar të dozimit terapeutik dhe kohëzgjatjen e trajtimit.

Rekomandohet referenca për udhëzimet aktuale të OBSH. Referenca për udhëzime të tjera klinike të bazuara në prova mund të bëhen, megjithatë mund të jetë e nevojshme që të trajtohen çështjet potenciale të konfliktit të interesit që mund të lidhen me udhërrëfyesit alternativë.

Konsiderata duhet t'i kushtohet gjithashtu çdo kërkesë shtesë që lidhet me trajtimin me barnat, siç janë testet diagnostike, pajisjet e specializuara të trajtimit, kërkesat e administrimit, kërkesat e monitorimit dhe nivelet e aftësive të ofruesve të kujdesit shëndetësor.

Aplikimi duhet të specifikojë nëse bari është duke u kërkuar të jetë në listën kryesore ose në listën plotësuese. Lista kryesore paraqet një listë të nevojave minimale të barit për një sistem shëndetësor bazë, duke renditur barnat më efektive, të sigurta dhe më kost-efektive për kushtet prioritare. Kushtet prioritare zgjidhen në bazë të relevancës së shëndetit publik dhe potencialit për sigurinë dhe kosto-efektivitetin. Lista plotësuese paraqet barnat esenciale për sëmundjet me prioritet, për të cilat nevojiten pajisje të specializuara diagnostikuese ose monitoruese, dhe / ose kujdes mjekësor të specializuar dhe / ose trajnim specialistik. Në rast dyshimi, barnat mund të renditen si plotësuese në bazë të kostove më të larta ose në kosto më efektive.

SHËNIM: Pikat 8, 9 dhe 10 janë elemente kritike mbi të cilat bëhen gjykimet e Komisionit të Ekspertëve. Dëshmitë në dispozicion për rëndësinë e shëndetit publik (pika 8), përfitimet klinike (pika 9) dhe dëmtimet (pika 10) duhet të paraqiten ndaras.

### 8. Informata që mbështet rëndësinë e shëndetit publik.

Aplikimi duhet të përfshijë informacion mbi nevojën e barit për shëndetin publik, duke përfshirë:

- Informacion epidemiologjik mbi sëmundjen
- Vlerësimi i përdorimit aktual
- Popullata e synuar
- Ndikimi i mundshëm i trajtimit në sëmundje

### 9. Shqyrtimi i përfitimeve: përmbledhje e efektivitetit krahasues në një shumëllojshmëri të mjediseve klinike.

- Identifikimi i evidencave klinike (strategjia e kërkimit, rishikimet sistematike të identifikuar, arsytet për përzgjedhjen / përjashtimin e të dhënave të veçanta)
- Përmbledhje e të dhënave në dispozicion (vlerësimi i cilësisë, masat e rezultateve, përmbledhja e rezultateve)
- Përmbledhje e vlerësimeve në dispozicion të efektivitetit krahasues

### 10. Shqyrtimi i dëmeve dhe toksicitetit: përmbledhje e provave mbi sigurinë.

- Vlerësimi i ekspozimit total të pacientit deri më tani
- Përshkrimi i efekteve / reagimeve negative dhe vlerësimet e frekuencës së tyre
- Përmbledhje e të dhënave në dispozicion (vlerësimi i cilësisë, përmbledhja e rezultateve)
- Përmbledhje e sigurisë krahasuese kundër barnave të konkurrencës.
- Identifikimi i ndryshimeve në siguri që mund të lidhen me sistemet shëndetësore dhe faktorët e pacientit

Aplikacioni duhet të vlerësojë të dhënat për të rriturit dhe fëmijët (kur është e aplikueshme për barin e propozuar). Aty ku është e mundur, duhet të paraqiten rishikime sistematike.

Nëse nuk disponohen të dhëna për disa popullsi (p.sh. pacientët pediatrikë, shtatzënat, pacientët e moshuar), kjo duhet të shprehet qartë në aplikacion.

Përmbledhjet e evidencës nga provat kryesore që përdorin rangimin e rekomandimeve, vlerësimin, zhvillimin dhe evaluimin (*Grading of Recommendations, Assessment, Development and Evaluation* - GRADE), duhet të përfshihen në aplikacion për të mbështetur efektivitetin krahasues dhe sigurinë krahasuese të barnave të propozuara. Më shumë informacion në lidhje me qasjen GRADE për vlerësimin e cilësisë së dëshmitë dhe fuqinë e rekomandimeve është në dispozicion në <http://www.gradeworkinggroup.org/>. Programi për prodhimin e tabelave të GRADE mund të shkarkohen nga <http://gradepro.org/>.

Ka mënyra alternative për paraqitjen e provave në dispozicion ose nga rishikimet sistematike ose të vetme. Gjasat krahasuese më të përshtatshme (testet e kontrolluara me randomizim, RCTs) mund të paraqiten duke treguar karakteristikat e pacientëve, rreziku bazë për rezultatet kryesore relevante në krahasim të trajtimit standard, dallimet absolute dhe masat e asociimit. Nëse kjo qasje alternative zgjidhet (sidomos kur vetëm një ose dy gjykime janë në dispozicion), sigurohuni që të ketë konsideratë adekuate për cilësinë e studimeve (ose rrezikun e paragjykitimit të studimit individual) së bashku me komentet mbi zbatueshmërinë/përgjithëshmërinë e të dhënave të gjykitimit (popullsia, ndërhyrjet, rezultatet e zgjedhura) dhe në mospërputhje midis studimeve që mund të zvogëlojnë cilësinë e provave.

### 11. Përmbledhje e të dhënave në dispozicion për koston krahasuese dhe kost-efektivitetin brenda klasës farmakologjike ose grupit terapeutik.

Gama e shpenzimeve të barnave të propozuara:

Tregoni çmimet e barnave nga vendet e mundshme ku bari është në dispozicion. Listimi në Udhëzuesin për Tregues të Çmimeve të Barnave të Shkencave të Menaxhimit të Shëndetit (Management Sciences for Health - MSH) mund të jetë një referencë e pranueshme. Është përditësuar çdo vit dhe është në dispozicion në <http://erc.msh.org/mainpage.cfm?file=1.0.htm&module=DMP&language=English>.

Të gjitha analizat e koston duhet të specifikojnë burimin e informacionit të çmimeve.

*Përdorimi i burimeve dhe kosto-efektiviteti krahasues paraqitet si rang i koston për rezultatin rutinë:*

Aplikimi duhet të paraqesë një rang të koston së vlerësuar për çdo rezultat rutinor si kostoja për një rast, kostoja për shërim, kostoja në muaj e trajtimit, kostoja për rast të parandaluar, kostoja për ngjarjen klinike të parandaluar.

Informatat nga analizat e kosto-efektivitetit të kryera në nivel kombëtar duhet të përfshihen aty ku janë të disponueshme për të siguruar udhëzime të përgjithshme nëse ndërhyrja ofron një vlerë të mirë për ta krahasuar me alternativat.

Aty ku është e mundur, aplikantët duhet të marrin në konsideratë ndikimin financiar të prodhimit të barit në kushtet e koston mesatare për pacient (globalisht) dhe popullatës në nevojë (mesatare ose dallimet në prevalencë) për të ndihmuar në zhvillimin e llogaritjeve të ndikimit buxhetor.

### Informacion ligjor

#### 12. Përmbledhje e statusit ligjor të barit

Aplikimi duhet të ofrojë një përmbledhje të statusit rregullator të barit të propozuar për përfshirje dhe të specifikojë indikacionet për të cilat bari ka marrë autorizimin për marketing nga AKPPM.

Kjo duhet të përfshijë statusin rregullator në vendin e origjinës, vendet e tjera dhe sipas autoriteteve të "Stringent" të rrepta rregullatore duke përfshirë:

- Administrata amerikane e ushqimit dhe barnave (FDA): <http://www.accessdata.fda.gov/scripts/cder/drugsatfda/>
- Agjencia Europiane e Barnave (EMA): <http://www.ema.europa.eu/ema/>
- Qeveria Australiane, Departamenti i Shëndetësisë, Administrata e Mallrave Terapeutike: <http://www.tga.gov.au/search/artg>
- Agjencia Japoneze e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore: <http://www.pmda.go.jp/english/index.html>
- Shëndeti Kanada: <http://www.hc-sc.gc.ca/dhp-mpps/prodpharma/index-eng.php>

Kur është e përshtatshme, duhet të përfshihet referenca në listën ekzistuese ose të planifikuar të barit të propozuar në listën e OBSH të Produkteve Medicinale të Parakualifikuara<sup>1</sup>.

<sup>1</sup> Lista e OBSH e produkteve medicinale të parakualifikuara përmban produkte medicinale të përdorura për HIV/AIDS, tuberkulozë, malarie dhe sëmundje të tjera, si dhe për shëndetin riprodhues, të cilat janë vlerësuar si pjesë e Programit Parakualifikues të OBSH-së dhe janë gjetur të pranueshme në parim për prokurimit nga agjencitë e OKB. Lista e barnave të parakualifikuara të OBSH mund të gjendet në: <http://apps.who.int/prequal/query/ProductRegistry.aspx>

### 13. Disponueshmëria e standardeve farmakopeale (Farmakopeja Britanike, Farmakopeja Ndërkombëtare, Farmakopeja e Shteteve të Bashkuara, Farmakopeja Europiane).

Aplikimi duhet të trajtojë nëse bari i propozuar është i përfshirë në të paktën një nga farmakopetë e mëposhtme:

- Farmakopeja Britanike
- Farmakopeja Ndërkombëtare
- Farmakopeja e Shteteve të Bashkuara
- Farmakopeja Evropiane

### 14. Lista e referencës.

Aplikimi duhet të referohet qartë, duke përdorur stilin e referencës së Vankuverit.

**Më shumë informata rreth procesit të revidimit të Listës së Barnave Esenciale mund të siguroni në ueb faqen e MSH-së: [msh.rks-gov.net](http://msh.rks-gov.net) (Rubrika: Revidimi i Listës së Barnave Esenciale)**

Formulari i aplikimit duhet të përmbajë:

\*Detajet e të gjitha pikave të cilat kërkohet të plotësohen mund t'i gjeni në informata për aplikuesit

Produktet e përgjithshme

1. Deklaratë përmbledhëse e propozimit për përfshirje, ndryshim ose fshirje.
2. Emri i departamentit teknik të MSH-së/SHSKUK dhe pikën fokale që mbështet aplikacionin (aty ku është relevante).
3. Emri i organizatës konsultuese dhe/ose që mbështet aplikacionin.
4. Emri i pambajtur ndërkombëtar (INN) dhe kodi anatomik terapeutik kimik (ATC) i barit.
5. Formulimi (et) dhe forca (t) e propozuara për përfshirje në listë; përfshirë të rriturit dhe fëmijët (nëse është e përshtatshme).

Detajet e disponueshmërisë aktuale të tregut të formulimit dhe forcës(ave) të propozuara duhet të përfshihen gjithashtu.

6. A kërkohet përfshirja në listë si bar individual apo si përfaqësues i një klase farmakologjike?

Detajet e trajtimit, rëndësia e shëndetit publik, vlerësimi dhe sinteza e provave

7. Detajet e trajtimit (kërkesat për diagnozën, trajtimin dhe monitorimin).
8. Informata që mbështet rëndësinë e shëndetit publik.
9. Shqyrtimi i përfitimeve: përmbledhje e efektivitetit krahasues në një shumëllojshmëri të mjediseve klinike.
10. Shqyrtimi i dëmeve dhe toksicitetit: përmbledhje e provave mbi sigurinë.
11. Përmbledhje e të dhënave në dispozicion për koston krahasuese dhe kost-efektivitetin brenda klasës farmakologjike ose grupit terapeutik.

Informacion ligjor

12. Përmbledhje e statusit ligjor të barit
13. Disponueshmëria e standardeve farmakopeale (Farmakopeja Britanike, Farmakopeja Ndërkombëtare, Farmakopeja e Shteteve të Bashkuara, Farmakopeja Europiane).
14. Lista e referencës.

## Barnat Esenciale

### Definicioni

### Definicioni

Barnat esenciale janë ato të cilat përmbushin nevojat prioritare të kujdesit shëndetësor të popullatës.

### Kriteret për selektimin e barnave esenciale

Barnat esenciale janë të përzgjedhura sipas prevalencës së sëmundjes dhe rëndësisë për shëndetin publik, evidencën për sigurinë dhe efikasitetin klinik si dhe krahasimin e kostos dhe kost-efektivitetin.

### Lista e Barnave Esenciale

Barnat esenciale kanë për qëllim të jenë në dispozicion në kontekstin e sistemeve shëndetësore funksionale në çdo kohë në sasi të mjaftueshme, në format e duhura të dozimit, me cilësi të sigurt dhe me një çmim që individit dhe komuniteti mund të përballojnë.

Lista Model është një udhëzues për zhvillimin e listave kombëtare dhe institucionale të barnave esenciale. Lista nuk ishte hartuar si një standard global. Megjithatë, për 30 vitet e fundit Lista Model ka çuar në një pranim global të konceptit të barnave esenciale si një mjet i fuqishëm për të promovuar barazinë shëndetësore. Shumica e vendeve kanë lista kombëtare dhe disa kanë lista provinciale ose shtetërore. Listat nacionale e barnave esenciale zakonisht lidhet ngushtë me udhërrëfyesit kombëtarë për praktikën klinike të kujdesit shëndetësor të cilat përdoren për trajnimin dhe mbikëqyrjen e punonjësve shëndetësorë.

### Lista aktuale e OBSH

Lista e 20-të e barnave esenciale e datës Mars 2017

### Lista aktuale e MSH

Lista e 3-të e barnave esenciale e vitit 2012

### Koncepti global

Koncepti i barnave esenciale është koncept i së ardhmes. Ky koncept përfshin nevojën që rregullisht të përditësohet përzgjedhja e barnave për të reflektuar alternativa të reja terapeutike dhe ndryshimin e nevojave terapeutike; për të siguruar cilësinë e barnave; dhe nevojën për zhvillimin e vazhdueshëm të barnave më të mira, barnave për sëmundjet në zhvillim dhe barnave që i përgjigjen vetive të ndryshimit të rezistencës.

Pasi mendohet se është e rëndësishme vetëm në mjediset e kufizuara nga resurset, Listat Model të OBSH tani konsiderohen me rëndësi të barabartë për vendet me të ardhura të larta, të mesme apo ato me të ardhura të ulëta, veçanërisht me përfshirjen e barnave të reja, shumë të efektshme dhe të shtrenjta në vitet e fundit.

### Evolucioni i mjekësisë dhe Lista Model e OBSH-së për Barnat esenciale

Në vitin 1897, aspirina u promovua si bari i parë sintetik. Në 100 vitet e fundit, bota ka parë zbulimin e antibiotikut të parë modern (1941), antimalarikun e parë me formulim komercial (1943), dhe antituberkularin e parë (1944). Në vitet e 1950-ta u bë përdorimi i parë klinik i kontraktivëve oralë, të barnave për diabet dhe të barnave për sëmundje mendore. Zhvillimi i barnave për sëmundje të tjera infektive, për sëmundjet kardiovaskulare dhe për një gamë të gjerë indikacioneve të tjera, vijuan shumë shpejt. Kur OBSH publikoi

Listën e parë të barnave esenciale në vitin 1977, identifikoi 208 barna individuale të cilat së bashku mund të siguronin trajtim të sigurt dhe efektiv për shumicën e sëmundjeve ngjithëse dhe jo të transmetueshme.

### Qasja, kualiteti dhe përdorimi racional i barnave esenciale

Ndikimi ekonomik i produkteve medicinale është i konsiderueshëm - sidomos në vendet në zhvillim. Ndërsa shpenzimet për prodhimet medicinale përfaqësojnë më pak se një të pestën e shpenzimeve totale shëndetësore publike dhe private në shumicën e vendeve të zhvilluara, ato përfaqësojnë 15-30% të shpenzimeve shëndetësore në ekonomitë në tranzicion dhe 25-66% në vendet në zhvillim. Në shumicën e vendeve me të ardhura të ulëta, produktet farmaceutike janë shpenzimet më të mëdha publike për shëndetin pas koston së personelit dhe shpenzimeve më të mëdha shëndetësore për amvisëritë. Dhe shpenzimet e sëmundjeve serioze familjare, duke përfshirë barnat, është një shkak kryesor i varfërimit në familje. Përkundër ndikimit të mundshëm shëndetësor të barnave esenciale dhe përkundër shpenzimeve substanciale për barnat, mungesa e qasjes në barna esenciale, përdorimi iracional i barnave dhe cilësia e dobët e barnave mbeten probleme serioze të shëndetit publik botëror:

Listat e barnave esenciale gjithashtu drejtojnë prokurimin dhe furnizimin e barnave në sektorin publik, skemat që rimburojnë shpenzimet e barnave, donacionet e barnave dhe prodhimin e barnave vendore. Shumë organizata ndërkombëtare, përfshirë UNICEF, UNHCR dhe UNFPA, si dhe organizatat joqeveritare dhe agjencitë ndërkombëtare të furnizimit jofitimprurës, kanë miratuar konceptin esencial të barnave dhe bazojnë sistemin e tyre të furnizimit me barna kryesisht në Listën Model të OBSH.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada-Government*  
**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJIS**  
**AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR**  
**AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE**  
**AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION**

Nr: 394/1  
 Dt: 06.09.2018

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 4, Ligjit të Punës nr03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018, Udhëzimit Administrativ 05/2015, si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

## KONKURS

**Për plotësimin e vendeve të lira të punës në Qendrën e Kompetencës në Skenderaj, Qendrën e Kompetencës në Ferizaj, Qendrën e Kompetencës në Malishevë Sh. M. L. T "11 Marsi" në Prizren për vitin shkollor 2018/2019**

| Niveli | Institucioni/Shkola  | Vendi     | Pozita/Vendi i lirë   | Vendi lirë/<br>Zëvendësim                         |
|--------|----------------------|-----------|---|---|
| SHML   | Qendra e Kompetencës | Ferizaj   | Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e matematikës me (14 orë mësimore);                          | Vend i lirë për një (1) vit shkollor              |
|        |                      |           | Një (1) mësimdhënës/c për lëndën e matematikës me (14 orë mësimore);                          | Vend i lirë për një (1) vit shkollor              |
|        |                      |           | 1 (një) Mësimdhënës/e me (16 orë mësimore); për lëndën e Gjuhës Angleze                       | Vend i lirë për një (1) vit shkollor              |
|        |                      |           | 1 (një) Mësimdhënës/e (me 10 orë mësimore); për lëndën e Mikrobiologjisë                      | Vend i lirë për një (1) vit shkollor              |
|        |                      |           | 1 (një) Instruktor për profilin Teknik i Optikës me (14 orë mësimore);                        | Vend i lirë për një (1) vit shkollor              |
|        |                      |           | 1 (një) Instruktor për profilin Asistent Kujdesi Social dhe Shëndetësor me (18 orë mësimore); | Zëvendësim deri në kthimin nga pushimi i lehonisë |
| Niveli | Institucioni/Shkola  | Vendi     | Pozita/Vendi i lirë   | Vendi lirë/<br>Zëvendësim                         |
| ShML   | Qendra e Kompetencës | Skenderaj | Një (1) mësimdhënës/e për profilin: Dizajni i tekstilit dhe veshjeve (20 orë mësimore);       | Zëvendësim deri në kthimin nga pushimi i lehonisë |
|        |                      |           | Një (1) mësimdhënës/e për lëndën Biznes dhe Ndërmarrësi i (20 orë mësimore);                  | Zëvendësim deri në kthimin nga pushimi i lehonisë |
|        |                      |           | Një (1) mësimdhënës/e për profilin: Arkitekturë (20 orë mësimore);                            | Zëvendësim deri në kthimin nga pushimi i lehonisë |
| Niveli | Institucioni/Shkola  | Vendi     | Pozita/Vendi i lirë   | Vendi lirë/<br>Zëvendësim                         |
| ShML   | Qendra e Kompetencës | Malishevë | 1 (një) Mësimdhënës/c me (10 orë mësimore); për lëndën e Gjuhës Gjermane                      | Vend i lirë deri në përfundim të vitit shkollor   |
| Niveli | Institucioni/Shkola  | Vendi     | Pozita/Vendi i lirë   | Vendi lirë/<br>Zëvendësim                         |
| ShMLT  | "11 Marsi"           | Prizren   | Një (1) mësimdhënës/e për lëndë profesionale për Dizajn me 20 orë mësimore                    | Vend i lirë deri në përfundim të vitit shkollor   |

### Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
